EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8426
E premte, 6 nëntor 2026
Çmimi 0. 50 €

Shiroka-Pula pret në takim ministrin e Jashtëm zviceran, flasin për investimet në Kosovë

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

GJASHTË VJET PADREJTËSI, LIDERËT E UÇK-së MBETEN SIMBOL I LUFTËS PËR LIRI DHE PAVARËSI

FAQE 4,5,6



Janë bërë gjashtë vjet nga arrestimi dhe transferimi në Hagë i liderëve të UÇK-së. Gjatë këtyre viteve strategët e lirisë janë ballafaquar me një proces gjyqësor të padrejtë dhe aspak transparentë i cili ka kulmuar me dënimin e tyre në shkallë të parë me 81 vjet burgim. Vendimi i Speciales është vlerësuar se nuk ka lidhje me drejtësinë, por mbi narrativen për ta rishkruar historinë e Kosovës, e cila është bërë shtet falë luftës së UÇK-së. Qëllimet e Speciales për dëmtimin e imazhit të liderëve të UÇK-së kanë qenë të kota, pasi popullariteti dhe mbështetja ndaj tyre është rritur si asnjëherë më parë. Sot Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi janë bërë sinonim i luftës për liri, pavarësi dhe dinjitet kombëtar

DIALOGU NË NGËRÇ: ÇFARË KARTASH KA ENDE BE-ja?

F. 3



KOMF-i I KËRKON KURTIT RREGULLIMIN E FINANCIMIT PËR SHËRBIMET SOCIALE PËRMES THEMELIMIT TË GRANTIT SPECIFIK PËR SHËRBIMET SOCIALE

F. 6



AKTUALE



IRANI KËRCËNON ME SULME PËRTEJ LINDJES SË MESME: A RREZIKOHET EVROPA?

F. 2

10 VJET NGA VDEKJA E ASTRIT DEHARIT, KURTI: ENDE NUK E DIMË EMRIN E VRASËSIT TË TIJ

F. 7

AKSION KUNDËR BIXHOZIT ILEGAL NË PRIZREN, SUHAREKË DHE DRAGASH, ARRESTOHEN 22 PERSONA

F. 6

EKONOMI



KOMISIONI EVROPIAN VLERËSON PËRPARIMIN E REFORMAVE NË SEKTORIN FINANCIAR DHE KONFIRMON QËNDRUESHMËRINË E SEKTORIT BANKAR NË KOSOVË

F. 8

KOSOVA DHE SLLOVENIA SYNOJNË ZGJERIMIN E BASHKËPUNIMIT EKONOMIK, NË FOKUS EDHE ENERGJIA

F. 8

SPORT



MË 20 DHJETOR FFK-ja ORGANIZON MANIFESTIMIN TRADICIONAL "LAUREATËT E VITIT 2026"

F. 11

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

VANCE NIS LËVIZJET PËR EPOKËN PAS TRUMPIT, KRITIKON LUFTËN ME IRANIN: HUMBËM ZGJEDHJET PËR KËTË ARSYE, SYTË NGA 2028

UASHINGTON, 5 NËNTOR - Humbja e republikanëve në zgjedhjet e mesmandatit në ShBA ka hapur debat për të ardhmen e Partisë Republikane dhe drejtimin që do të marrë lëvizja MAGA pas Donald Trump. Në këtë situatë, zëvendëspresidenti J. D. Vance ka bërë ndërhyrjen e tij të parë të rëndësishme politike, duke kritikuar ndikimin e luftës me Iranin në rezultatin zgjedhor dhe duke paraqitur disa propozime për rikthimin e mbështetjes së votuesve.

Sipas një analize të CNN-it, deklaratat e Vances shihen si një përpjekje për të marrë një rol më të rëndësishëm në drejtimin e kampit republikan dhe për ta pozicionuar veten në garën politike që pritet të zhvillohet në prag të zgjedhjeve presidenciale të vitit 2028.

Kontrasti mes presidentit Trump dhe zëvendëspresidentit të tij u vu re menjëherë pas rezultatit zgjedhor. Ndërsa Trump u shfaq në Shtëpinë e Bardhë duke ndjekur punimet për ndërtimin e sallës së re të vallëzimit, Vance publikoi një analizë të drejtpërdrejtë mbi arsyet e humbjes së republikanëve. Ai ia atribuoi një pjesë të rëndësishme të rezultatit luftës me Iranin, por pranoi gjithashtu se administrata nuk kishte arritur t'ua përcillte në mënyrë bindëse amerikanëve mesazhin e saj ekonomik.

Në reagimin e tij, zëvendëspresidenti theksoi se konflikti me Iranin dhe pasojat ekonomike të tij ndikuan në pakënaqësinë e votuesve. "Arsyeja pse humbëm është lufta", shkroi Vance, duke e lidhur rezultatin zgjedhor me konfliktin dhe rritjen e çmimeve të karburanteve. Ai pranoi se mesazhi ekonomik i republikanëve nuk kishte qenë mjaftueshëm efektiv, veçanërisht në një periudhë kur amerikanët po përballeshin me koston e lartë të jetesës.

Vance la të kuptohet gjithashtu se partia duhet të rishikojë disa prej prioriteteve të saj, përfshirë mënyrën e zbatimit të politikës së emigracionit. Ai propozoi që vëmendje më e madhe t'u kushtohet bizneseve që punësojnë emigrantë në mënyrë të paligjshme.

Zëvendëspresidenti bëri me dije se kishte kërkuar edhe mendimin e një anketuesi me përvojë për mënyrat se si



republikanët mund të rikthejnë votuesit e zhgënjyer.

Nga ky diskutim dolën katër prioritete: përfundimi i luftës, përballja me inflacionin dhe rritjen e çmimeve, rikthimi te doktrina "Amerika e Para" dhe rishikimi i marrëdhënieve të ShBA-së me Izraelin.

Pavarësisht prej deklaratave të Vances, Donald Trump nuk dha sinjale se ishte penduar për vendimin për ndërhyrjen ushtarake.

Presidenti amerikan deklaroi se nuk do të kishte bërë asgjë ndryshe, duke e konsideruar konfliktin një vendim të domosdoshëm, pavarësisht prej kostos politike dhe ndikimit në çmimet e karburanteve.

Megjithatë, Trumpi pranoi se Vance mund të kishte të drejtë kur thoshte se lufta kishte ndikuar në rezultatin zgjedhor, pasi kishte shkaktuar rritje të çmimeve të benzinës në afat të shkurtër.

Sipas CNN-it, kjo tregon një ndryshim në mënyrën se si të dy e interpretojnë humbjen: Trumpi e sheh koston si një sakrificë të nevojshme, ndërsa Vance kërkon që konflikti të merret në konsideratë si një faktor që duhet rishikuar në strategjinë e ardhshme të republikanëve.

Një tjetër element i rëndësishëm i deklaratave të zëvendëspresidentit është afrimi me krahun më izolacionist të lëvizjes MAGA, i cili kundërshton përfshirjen e ShBA-së në konflikte të huaja.

Referencat e tij ndaj doktrinës "Amerika e Para" dhe nevojës për t'i rishikuar marrëdhëniet me Izraelin shihen nga CNN si pjesë e përpjekjeve për të krijuar aleanca të reja brenda kampit konservator.

Në këtë grupim ka ndikim edhe komentatori Tucker Carlson, i cili ka shprehur kundërshtime ndaj ndërhyrjeve ushtarake amerikane jashtë vendit.

Megjithatë, Vance përballet me një kontradiktë politike, pasi vetë ka qenë pjesë e ekipit negociator për arritjen e një marrëveshjeje me Teheranin, e cila synonte t'i jepte fund konfliktit, por që nuk funksionoi.

Në debatin për të ardhmen e republikanëve është përfshirë edhe guvernatori i Floridës, Ron DeSantis, i cili e ka përshkruar rezultatin zgjedhor si një goditje me pasoja të mundshme afatgjatë për partinë.

Në një reagim në rrjetin social X, DeSantis paralajmëroi se republikanët mund të mos kenë mundësi ta rikthejnë kontrollin e Senatit deri në vitin 2032. Ai e përshkroi situatën si një rezultat që u afrohet "niveleve të zhdukjes politike", duke vënë në dukje rëndësinë e Teksasit për të ardhmen elektorale të republikanëve. Sipas analizës së CNN-it, deklaratat e Vances dhe DeSantis tregojnë se gara për drejtimin e ardhshëm të Partisë Republikane ka nisur të marrë formë, ndërsa humbja në zgjedhjet e mesmandatit ka përshpejtuar diskutimet për epokën pas Trumpit.

Viti 2028, kur amerikanët do të votojnë për presidentin e ri, po shfaqet kështu si horizonti kryesor i përplasjes politike brenda kampit republikan.

IRANI KËRCËNON ME SULME PËRTEJ LINDJES SË MESME: A RREZIKOHET EVROPA?

TEHRAN, 5 NËNTOR - Irani dhe Shtetet e Bashkuara kanë shkëmbyer kërcënime për javë të tëra, ani pse po vazhdojnë përpjekjet diplomatike. Megjithatë, mundësia e një përshkallëzimi ushtarak pas zgjedhjeve të mesmandatit në ShBA ekziston ende.

Lideri suprem i Iranit, Mojtaba Khamenei, u kërkoi forcave të armatosura të jenë të gatshme t'i përgjigjen çfarëdo sulmi "menjëherë, në mënyrë efektive dhe pa kufizime gjeografike", në një deklaratë të publikuar më 31 tetor.

Pikërisht kjo pjesë e deklaratës ka nxitur thashetheme në Iran se çfarë mund të nënkuptojë ajo dhe nëse Teherani ka kapacitetet për ta çuar deri në fund këtë kërcënim.

Kur Shtetet e Bashkuara dhe Izraeli sulmuan për herë të parë Iranin, më 28 shkurt, Teherani u kundërpërgjigj duke goditur caqe ushtarake dhe civile në shtetet arabe përgjatë Gjirit Persik. Ai këmbëngulte se po shënjestronte interesat amerikane në rajon.

Analistët thonë se Republika Islamike shpresonte që zgjerimi i konfliktit në nivel rajonal dhe goditja e territorit të aleatëve të ShBA-së do ta detyronte Uashingtonin t'i ndalte sulmet.

Tani disa zëra në Teheran sugjerojnë se faza e ardhshme e luftës, nëse ajo rifillon, siç ka kërcënuar presidenti amerikan Donald Trump, mund të shtrihet edhe më tej. Ligjvënësi konservator dhe ish-ministri i Jashtëm, Manuchehr Mottaki, tha se konflikti i ardhshëm "nuk do të jetë luftë rajonale".

Duke folur në televizionin shtetëror pas publikimit të deklaratës së Khameneit, Mottaki lavdëroi kapacitetet raketore të Iranit dhe paralajmëroi se, nëse Irani sulmohet, lufta që do të pasojë "do të arrijë deri në Evropë".

Edhe komentatori konservator Ali Qolhaki shprehu të njëjtin qëndrim. Në një postim në rrjetin X, ai shkroi se kërcënimi për zgjerimin e objektivave të Iranit përtej rajonit ka gjasë t'i referohet Evropës. Sipas tij, në shënjestrën e Iranit tani mund të jenë vende si Britania e Madhe, Italia, Greqia dhe Gjermania, të cilat strehojnë forca të armatosura amerikane dhe janë pjesë e dislokimit global ushtarak të Uashingtonit dhe rrjetit të tij të mbështetjes logjistike.

Ndërkohë, mediet iraniane e kanë paraqitur deklaratën si shenjë se Teherani mund të jetë duke ndryshuar politikën për rrezen e veprimit të raketave të tij.

Për vite me radhë Irani ka mbajtur një kufizim prej 2 000 kilometrash për rrezen e veprimit të raketave të tij. Ish-lideri suprem Ajatollah Ali Khamenei kishte thënë se këtë kufizim e kishte vendosur vetë pavarësisht prej kundërshtimeve të zyrtarëve ushtarakë.

Tani disa medie sugjerojnë se Khamenei i ri, i cili nuk është shfaqur në publik që nga sulmet e 28 shkurtit, ku u vra babai i tij, po e heq këtë kufizim.

Agjencia gjysmëzyrtare e lajmeve, ISNA, tha se deklarata sinjalizon një ripërcaktim të rrezes gjeografike brenda së cilës forcat e armatosura janë të gatshme të kryejnë sulme dhe mund të përbëjë ndryshim në konsideratat strategjike që përcaktojnë politikën raketore të Iranit.

Klubi i Gazetarëve të Rinj, i lidhur me transmetuesin shtetëror IRIB, shkoi edhe më tej. Ai tha se lista e objektivave të Iranit është përditësuar dhe se aftësitë e tij parandaluese tashmë shtrihen "përtej rajonit".

Ai theksoi se Shtetet e Bashkuara kanë të paktën 128 baza dhe objekte ushtarake në 51 vende, nga Lindja e Mesme, Evropa, Afrika e deri në Azinë Lindore. Ajo tha se "bazat e agresorëve kudo në botë" tashmë janë pjesë e listës së objektivave të forcave të armatosura iraniane.

"Teherani po përgatitet t'i përgjigjet me forcë një sulmi amerikano-izraelit, i cili, sipas vlerësimeve, pritet të jetë veçanërisht i gjerë dhe i dhunshëm", tha Danny Citrinowicz, bashkëpunëtor i jashtëm në Këshillin Atlantik. "Për më tepër, duket se iranianët po synojnë ta zgjerojnë listën e objektivave, duke përfshirë edhe asete që nuk ishin goditur në fushatat e mëparshme. Këtu bëjnë pjesë infrastruktura e



komunikimit dhe objekte të tjera strategjike në vendet e Gjirit Persik. Kjo nënkupton se fushata e ardhshme, nëse nis, mund të jetë shumë më e gjerë, më e gjatë dhe më rraskapitëse sesa shpreson Uashingtoni", shtoi ai.

Megjithatë, jo të gjithë janë të bindur se kjo retorikë nënkupton ndryshim të politikës. E përditshmja reformiste "Etemad" paralajmëroi se kërkesa për raketa me rreze më të gjatë veprimi, zotërimi i kapaciteteve teknike për t'i prodhuar ato dhe marrja e një vendimi zyrtar për ndryshimin e politikës, janë tri gjëra të ndryshme.

Jeremy Binnie, analist i mbrojtjes për Lindjen e Mesme në kompaninë globale të inteligjencës, Janes, ofroi një interpretim tjetër. Ai tha se referenca ndaj kufizimeve gjeografike mund të mos ketë të bëjë fare me distancën. Sipas tij, Irani mund të ketë marrëveshje me një ose më shumë shtete arabe të Gjirit Persik për të mos i shënjestruar ato. Ai shtoi se ky është "një kufizim që mund të hiqet".

Binnie tha se Irani ka pasur mundësi t'ua zgjerojë rrezen e veprimit raketave përtej 2 000 kilometrave, pasi rrezja mund të rritet duke zvogëluar peshën e kokës bërthamore.

Raketa Khorramshahr, e paraqitur në vitin 2017, është ajo së cilës mund t'i zgjerohet rrezja e veprimit. Sipas Binniet, ajo është "raketa më e fuqishme" e Iranit. Ai tha se vlerësohet se kjo raketë mund të ketë rreze veprimi prej 3 000 kilometrash, nëse pajiset me një mjet rihyrës prej 750 kilogramësh, relativisht të vogël.

Kufizimi prej 2 000 kilometrash "kishte njëfarë logjike", tha Binnie, pasi i mundësonte Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC) të godiste "pothuajse gjithçka që do t'i duhej të shënjestronte në rajon", pa kërcënuar Evropën, me përjashtim të Qipros dhe disa ishujve grekë.

Për të arritur në Evropën Perëndimore, Iranit i duhet ta zgjerojë rrezen e veprimit të raketave të tij. Sipas tij, objektivi më i dukshëm përtej kësaj distance do të ishte "Diego Garcia", baza e përbashkët ushtarake amerikano-britanike në Oqeanin Indian, rreth 4 000 kilometra larg territorit iranian.

Britania e Madhe tha se Irani ishte përpjekur ta godiste këtë bazë më 20 mars, por kishte dështuar. Megjithatë, të paktën një zyrtar iranian e mohoi se ishte bërë një përpjekje e tillë.

EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

DIALOGU NË NGËRÇ: ÇFARË KARTASH KA ENDË BE-ja?

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Marrëveshje të pazbatuara, dialog i bllokuar politik dhe kritika të reja nga Bashkimi Evropian. Në raportet e sivjetme të përparimit, Komisioni Evropian kritikon Kosovën dhe Serbinë për mospërmbushjen e obligimeve në procesin e normalizimit të marrëdhënieve. Por, edhe vetë dialogu që ndërmjetëson Brukseli nuk ka shënuar përparim të dukshëm politik prej më shumë se tre vjetësh.

Takimi i fundit i nivelit të lartë u zhvillua në shtator të vitit 2023. Që atëherë bisedimet kanë vazhduar në nivel kryenegociatorësh, por pa i afruar palët drejt një marrëveshjeje të mundshme.

Prishtina e kushtëzon rikthimin në takimet e nivelit të lartë me dorëzimin e Millan Radoiçiqit, ish-politikanit serb të Kosovës që mori përgjegjësinë për sulmin e armatosur në Banjskë, në shtator të vitit 2023.

Beogradi, ndërkaq, këmbëngul në themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë.

Njohës të procesit vlerësojnë se BE-ja ka ende instrumente politike dhe financiare për t'i nxitur palët drejt normalizimit. Por, mospajtimet brenda bllokut dhe mungesa e një strategjie të qartë, sipas tyre, e kanë kufizuar ndikimin e saj.

Donika Emini, nga Grupi Këshillues për Politikat e Ballkanit në Evropë, thotë se Brukseli mund të përdorë më shumë stimuj për të dyja vendet, krahas masave ndëshkuese.

Për Kosovën ajo përmend avancimin e aplikimit për anëtarësim në BE, përfitimet nga Plani i Rritjes dhe mbështetjen financiare e politike për integrim. Për Serbinë mundësitë lidhen kryesisht me negociatat e anëtarësimit. "Hapja dhe mbyllja e kapitujve negociues, qasja në fondet evropiane, përfitimet nga Plani i Rritjes dhe avancimi i përgjithshëm në procesin e integrimit mund të kushtëzohen shumë më qartë me përparimin në reformat demokratike, sundimin e ligjit dhe normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën", thotë Emini për Radion Evropa e Lirë.

Edhe Toby Vogel, nga Këshilli për Demokratizimin e Politikave në Bruksel, vlerëson se BE-ja ka hapësirë për të vepruar, por kërkon një angazhim të mirëfilltë të Serbisë në dialog dhe një perspektivë reale për arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse, ligjërisht të detyrueshme.

Paralelisht, sipas tij, Brukseli



duhet ta avancojë aplikimin e Kosovës për anëtarësim, i cili ka mbetur pa u shqyrtuar që nga dhjetori i vitit 2022. "Është e tmerrshme që aplikimi i Kosovës për anëtarësim në BE gjendet prej vitesh në sirtarët e Brukselit dhe Komisioni nuk e adreson. Askush nuk mund të më bindë se, me vullnetin e duhur politik, nuk mund të gjendet një zgjidhje kreative që t'i lejojë një shteti, të cilin nuk e njohin të gjitha vendet anëtare, të paktën ta nisë procesin e anëtarësimit", thotë Vogel.

Radio Evropa e Lirë iu drejtua Bashkimit Evropian me pyetje për instrumentet që ka në dispozicion për ta zhbllokuar dialogun, mundësinë e përdorimit të tyre dhe planet për rifillimin e takimeve të nivelit të lartë mes Kosovës dhe Serbisë, por nuk mori përgjigje.

A mjaftojnë stimujt financiarë?

Për Eminin, vetëm premtimi për fonde dhe asistencë financiare nuk mjafton për t'i bindur palët të angazhohen seriozisht.

BE-ja tashmë ka Planin e Rritjes për Ballkanin Perëndimor, i cili parasheh mbështetje financiare në këmbim të reformave.

Angazhimi konstruktiv në normalizimin e marrëdhënieve është kusht edhe për Kosovën, edhe për Serbinë. Por, sipas Eminit, përvoja e vitit 2013 dëshmon se stimujt politikë mund të kenë ndikim më të madh.

Pas Marrëveshjes së parë të Brukselit, Serbisë iu hap rruga drejt negociatave për anëtarësim, ndërsa Kosova përparoi drejt Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. "Mendoj se kjo logjikë duhet të rikthehet, por në një mënyrë më të qëndrueshme dhe më substanciale: përparimi real në integrimin evropian duhet të shoqërohet me angazhim real në dialog dhe zbatim të marrëveshjeve", vlerëson ajo.

Emini kërkon përfshirje më aktive të shteteve kryesore të BE-së dhe një strategji që përcakton qartë se çfarë përfiton secila palë nëse i përmbush obligimet dhe me çfarë pasojash përballet nëse nuk i zbaton ato.

Vogel, megjithatë, e vë në pikëpyetje nëse marrëveshjet ekzistuese mund ta çojnë procesin drejt një zgjidhjeje përfundimtare. "Më duket se BE-ja i ka humbur levat e ndikimit gjatë viteve të fundit", thotë ai. "Edhe nëse këto marrëveshje zbatohen nesër, a na sjellin vërtet më afër marrëveshjes përfundimtare? Nuk jam i sigurt".

A ka nevojë BE-ja për një qasje të re?

Kritikat ndaj Brukselit nuk lidhen vetëm me efektivitetin e instrumenteve të tij, por edhe me mënyrën se si i ka trajtuar palët në dialog.

Në vitin 2023 BE-ja vendosi masa ndëshkuese ndaj Kosovës për shkak të tensioneve në veri dhe veprimeve të qeverisë që i cilësoi si të njëanshme. Masat kufizuan bashkëpunimin politik dhe një pjesë të mbështetjes financiare.

Sipas Raportit të Progresit për vitin 2026, ato u hoqën pas transferimit të rregullt të pushtetit lokal në veri, pas zgjedhjeve të vitit 2025.

Autoritetet e Kosovës e kanë kritikuar BE-në për standarde të dyfishta, duke theksuar mungesën e masave ndaj Serbisë pas sulmit në Banjskë - pretendim që BE-ja e ka hedhur poshtë.

Edhe Vogel vlerëson se Brukseli ka ushtruar më shumë presion ndaj Prishtinës sesa Beogradit.

Sipas tij, dialogu është larguar nga synimi për një marrëveshje përfundimtare dhe është përqendruar kryesisht në menaxhimin e krizave. "BE-ja duhet ta ndryshojë qasjen, të ndryshojë mënyrën se si sillet me të dyja palët dhe të heqë dorë nga ideja se duhet t'i japim dicka Serbisë që ta pranojë pavarësinë e Kosovës, sepse ky nuk është një lëshim, por pranim i realitetit", thotë Vogel.

Emini, ndërkaq, ia atribuon ngecjen mungesës së vullnetit politik të palëve, bllokadave institucionale në Kosovë dhe qasjes së Brukselit. "Në njëfarë mënyre, është krijuar përshtypja se Brukseli është kënaqur me vazhdimin e komunikimit në nivel teknik, ndërkohë që dialogu politik është shtyrë vazhdimisht, për shkak të rrethanave të brendshme në të dyja vendet", thotë ajo.

A mund të sjellin zhvillimet politike një fillim të ri për dialogun?

Zhvillimet e fundit politike në Kosovë dhe Serbi mund të ndikojnë në të ardhmen e dialogut, por nuk pritet ta zhbllokojnë menjëherë atë.

Kosova ka tashmë një qeveri me mandat të plotë katërvjeçar, të udhëhequr nga Albin Kurti, e cila u votua në shtator, pas një periudhe të gjatë bllokadash institucionale.

Në Serbi zgjedhjet e tetorit sollën ndryshimin e pushtetit.

Lista Studentore, e dalë nga protestat kundër qeverisjes, i dha fund sundimit 14-vjeçar të Aleksandar Vuçiqit.

Ndërsa Serbia është në procesin e formimit të institucioneve të reja, as Emini dhe as Vogel nuk presin takim të nivelit të lartë gjatë pjesës së mbetur të vitit.

Vogel vlerëson se Brukseli duhet të vendosë kontakte me udhëheqjen e re serbe, pa ushtruar menjëherë presion mbi të. "Do të ishte e çuditshme, në aspektin politik, t'u bësh presion njerëzve që janë më shumë në anën tuaj dhe shumë më konstruktivë - ose të paktën kështu mendojmë se janë - sesa kishim vullnet t'i bënim presion Vuçiqit", thotë ai.

Megjithatë, sipas tij, do të duhen muaj për të kuptuar orientimin e pushtetit të ri, pasi Lista Studentore përfshin si elemente properëndimore, ashtu edhe proruse e nacionaliste.

Edhe Emini është e rezervuar ndaj pritjeve për ndryshim të politikës së Beogradit ndaj Kosovës. "Është shumë herët të themi nëse ky ndryshim do të jetë pozitiv apo negativ për procesin e normalizimit të marrëdhënieve me Kosovën", thotë ajo.

Lista Studentore, ashtu si pushteti i deritanishëm në Serbi, e konsideron Kosovën pjesë të territorit serb, ndonëse ajo ka shpallur pavarësinë në vitin 2008.

Bartësi i saj, Ilija Srdanoviq, i ka thënë më herët REL-it se vazhdimi i dialogut për "çështjen e Kosovës dhe Metohisë" është pjesë e planit të saj.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka shprehur pritjen që udhëheqja e re në Beograd ta ndryshojë qëndrimin ndaj pavarësisë së Kosovës.

Megjithatë, mbetet e paqartë nëse stabilizimi institucional në Kosovë dhe ndryshimi i pushtetit në Serbi do të sjellin edhe përparim në dialog.

Për BE-në, kjo do të jetë një tjetër provë e aftësisë për t'i kthyer angazhimet politike në zbatim të marrëveshjeve.

Çfarë sollën 15 vjet dialog?

Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë nisi në mars të vitit 2011, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, fillimisht për çështje teknike e më pas edhe politike.

Gjatë këtyre viteve palët arritën marrëveshje për lëvizjen e lirë, njohjen e dokumenteve, regjistrat civilë, doganat, energjinë dhe telekomunikacionin, disa prej të cilave janë zbatuar plotësisht ose pjesërisht.

Marrëveshja e Brukselit e vitit 2013 parashikoi integrimin e strukturave serbe të sigurisë dhe drejtësisë në institucionet e Kosovës si dhe themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe i cili ende nuk është krijuar.

Në vitin 2023 Kosova dhe Serbia u pajtuan për Marrëveshjen për rrugën drejt normalizimit dhe aneksin e zbatimit në Ohër, por shumica e obligimeve mbeten të papërmbushura.

Pavarësisht prej marrëveshjeve dhe disa rezultateve praktike, procesi nuk ka çuar në njohjen e ndërsjellë apo në një marrëveshje përfundimtare për normalizimin e marrëdhënieve.

BE-ja synon arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse, ligjërisht të detyrueshme, për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Shtetet e Bashkuara, të cilat mbështesin dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja, kanë mbajtur qëndrimin se normalizimi i marrëdhënieve duhet të çojë drejt njohjes së ndërsjellë.

Shiroka-Pula pret në takim ministrin e Jashtëm zviceran, flasin për investimet në Kosovë

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Justina Shiroka-Pula, priti në takim ministrin e Punëve të Jashtme të Zvicrës, njëherësh kryesues i OSBE-së, Ignazio Cassis.

Gjatë takimit presidentja Shiroka-Pula potencoi marrëdhëniet e shkëlqyeshme ndërmjet Kosovës dhe Zvicrës, duke e falënderuar ministrin Cassis për mbështetjen e vazhdueshme të Zvicrës për Kosovën. Ajo theksoi rëndësinë e thellimit të mëtejmë të marrëdhënieve ekonomike, rritjes së shkëmbimeve tregtare dhe shtimit të pranisë së investimeve zvicerane në Kosovë.

Presidentja vlerësoi bilancin e mirë tregtar ndërmjet dy vendeve, duke theksuar se ekziston potencial për ta rritur edhe më tej atë nëpërmjet mundësive që ofron EFTA.

Presidentja theksoi nevojën për vazhdimin e mbështetjes së Zvicrës për fuqizimin e pozitës së Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe në procesin e anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare.

Në këtë kontekst presidentja Shiroka-Pula theksoi rëndësinë e mërgatës shqiptare, e cila kontribuon aktivisht në Zvicër dhe përbën një urë të fuqishme lidhëse ndërmjet dy shteteve. Ajo shprehu mirënjohjen për angazhimin e kontingjentit zviceran të KFOR-it në Kosovë që nga viti 1999.

Nga ana e tij, ministri Cassis rikonfirmoi se Zvicra do të vazhdojë të jetë përkrah



Kosovës edhe në të ardhmen, duke shprehur mbështetjen e tij edhe për presidenten Shiroka-Pula.



GJASHTË VJET PADREJTËSI, LIDERËT E UÇK-së MBETEN SIMBOL I LUFTËS PËR LIRI DHE PAVARËSI

Janë bërë gjashtë vjet nga arrestimi dhe transferimi në Hagë i liderëve të UÇK-së. Gjatë këtyre viteve strategët e lirisë janë ballafaquar me një proces gjyqësor të padrejtë dhe aspak transparentë i cili ka kulmuar me dënimin e tyre në shkallë të parë me 81 vjet burgim. Vendimi i Speciales është vlerësuar se nuk ka lidhje me drejtësinë, por mbi narrativen për ta rishkruar historinë e Kosovës, e cila është bërë shtet falë luftës së UÇK-së. Qëllimet e Speciales për dëmtimin e imazhit të liderëve të UÇK-së kanë qenë të kota, pasi popullariteti dhe mbështetja ndaj tyre është rritur si asnjëherë më parë. Sot Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi janë bërë sinonim i luftës për liri, pavarësi dhe dinjitet kombëtar

EPOKA E RE **Lirim GECI**

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Gjashtë vjet pritje, gjashtë vjet larg familjeve, gjashtë vjet në Hagë dhe një aktgjykim që më 16 shtator 2026 tronditi Kosovën. Për shumicën e qytetarëve të Kosovës dhe shqiptarëve anekënd botës, vendimi ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit nuk ishte thjesht një zhvillim gjyqësor, por një goditje e rëndë emocionale që riktheu në kujtesë luftën, sakrificën, çlirimin dhe rrugën e vështirë drejt shtetndërtimit.

Të enjten, më 5 nëntor, janë bërë gjashtë vjet nga arrestimi dhe transferimi në Hagë i katër liderëve të UÇK-së. Që nga ajo ditë familjet e tyre kanë jetuar larg tyre, ndërsa Kosova e ka përcjellë procesin mes pritjes, shqetësimit, protestave dhe shpresës për një përfundim që do të sillte lehtësim për të akuzuarit dhe mbështetësit e tyre.

Më 3 prill 2023 kishte nisur gjykimi në Dhomat e Specializuara të Kosovës. Prokuroria kishte paraqitur pretendimet për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, ndërsa mbrojtja i kishte kundërshtuar akuzat, duke këmbëngulur në pafajësinë e katërshes së UÇK-së. Për vite me radhë, dëshmitë, provat dhe interpretimet e ngjarjeve të luftës janë shqyrtuar në një proces që është bërë pjesë e debatit të përditshëm në Kosovë, por për ta kuptuar peshën që ky proces ka për shoqërinë e Kosovës, duhet të kthehemi pas në kohë, te vitet 1998-1999.

Lufta që ndryshoi historinë e Kosovës

Në fund të viteve '90 Kosova po përjetonte një periudhë të rëndë represioni dhe dhune. Familje të tëra ishin detyruar të largoheshin nga shtëpitë e tyre, fshatra ishin shkatërruar dhe mijëra njerëz kishin humbur jetën. Në këtë rrethanë Ushtria Çlirimtare e Kosovës u shfaq si një organizim i armatosur që synonte t'u kundërvihej forcave serbe dhe të çonte përpara kërkesën për liri. Lufta e UÇK-së është bërë një nga kapitujt më të rëndësishëm të historisë moderne të Kosovës. Ajo është shoqëruar me sakrifica të mëdha, me dëshmorë e martirë dhe me vuajtje të rënda të popullsisë civile. Ndërhyrja e NATO-s në vitin 1999 dhe tërheqja e forcave jugosllave dhe serbe shënuan një kthesë vendimtare, ndërsa Kosova nisi rrugën e gjatë drejt pavarësisë, të shpallur më 17 shkurt 2008. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi ishin ndër figurat e njohura të UÇK-së. Për shumë qytetarë emrat e tyre lidhen me luftën çlirimtare dhe me rrugëtimin politik që pasoi. Për këtë arsye gjykimi ndaj tyre nuk është përjetuar vetëm si një çështje individuale penale, por edhe si një çështje që prek kujtesën kolektive dhe mënyrën se si Kosova e kupton historinë e vet. Megjithatë, në aspektin juridik, përgjegjësia penale duhet të vlerësohet individualisht, mbi bazën e provave dhe procedurave gjyqësore. Nderimi i sakrificës së popullit dhe i luftës për liri nuk e zëvendëson drejtësinë, ashtu siç drejtësia nuk duhet të shndërrohet në gjykim të një populli të tërë për historinë e tij.

16 shtatori, dita që tronditi Kosovën dhe shqiptarët

Më 16 shtator 2026 trupi gjykues ka shpallur aktgjykimin e shkallës së parë. Hashim Thaçi dhe Jakup Krasniqi janë dënuar me nga 25 vjet burgim, Kadri Veseli me 18 vjet, ndërsa Rexhep Selimi me 13 vjet burgim. Katër liderët e UÇK-së janë liruar nga akuzat për krime kundër njerëzimit, por janë shpallur fajtorë për disa akuza për krime lufte.

Vendimi ka shkaktuar reagime të ashpra në Kosovë. Si asnjëherë më parë, qytetarë të shumtë kanë dalë në sheshet e Prishtinës, në qytete të tjera dhe në diasporë për të protestuar kundër dënimeve, ndërsa familjarë, veteranë të UÇK-së dhe përfaqësues të organizatave të dala nga lufta kanë kërkuar që vendimi të kundërshtohet përmes rrugëve ligjore.

Protestat kanë vazhduar edhe në ditët pas shpalljes së aktgjykimit, duke dëshmuar se çështja ka një peshë të madhe në ndërgjegjen publike. Për shumë protestues dënimet janë vlerësuar si padrejtësi ndaj njerëzve që i lidhin me luftën për çlirimin e vendit. Në sheshe janë rikthyer flamujt e UÇK-së, thirrjet për drejtësi dhe kërkesat që institucionet e Kosovës të ndërmarrin hapa ligjorë. Në të njëjtën kohë, debati është shtrirë edhe te mandati i Dhomave të Specializuara, mënyra e funksionimit të tyre dhe ndikimi i procesit në raportin e shoqërisë me të kaluarën.

Pas 16 shtatorit përplasjet politike dhe përpjekjet për ndryshime ligjore lidhur me Gjykatën Speciale e kanë zgjeruar debatin përtej sallës së gjyqit. Këto zhvillime kanë ngritur pyetje për kufijtë e veprimit të institucioneve vendore, detyrimet ndërkombëtare të Kosovës dhe mënyrën se si duhet të trajtohen vendimet që shkaktojnë reagime të mëdha shoqërore. Në këtë kontekst, Kuvendi i Kosovës ka miratuar më 6 tetor 2026 ndryshimet në Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe

“2 191 ditë histori nuk mund të burgosen”, afër ambasadave të huaja shkruhen grafite që tregojnë padrejtësinë ndaj krerëve të UÇK-së

Në përvjetorin e gjashtë të arrestimit të krerëve të UÇK-së janë parë disa grafite afër ambasadave të huaja në Prishtinë. Në këto grafite, që duket se janë vënë natën, numërohen ditët e qëndrimit në Hagë të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Në këto grafite në gjuhën shqipe dhe atë angleze shkruhet dhe tregohet padrejtësia ndaj liderëve të UÇK-së.



Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Gjykata Speciale), me 88 vota për, pas një nisme të propozuar nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Ndërsa presidentja e Republikës së Kosovës, Justina Shiroka-Pula, më 22 tetor ka marrë vendim për kthimin e këtij ligji në Kuvend. Një vendim i tillë është marrë pas kërkesës së PDK-së, e cila ka kërkuar të bëhen disa ndryshime në Ligjin për Gjykatën Speciale. Krahas kësaj, Qeveria e Kosovës, më 14 tetor ka emëruar një grup punues i cili do të merret me hartimin, koordinimin dhe harmonizimin e strategjisë shtetërore lidhur me procedurat e apelit para Dhomave të Specializuara në Hagë.

Drejtësia, historia dhe pritja përfundimtare

Për familjen e Thaçit, të Veselit, të Krasniqit dhe të Selimit gjashtë vitet e fundit kanë qenë vite largësie dhe pritjeje. Për mbështetësit e tyre, kanë qenë vite shprese për kthimin e tyre në Kosovë, ndërsa për një pjesë të madhe të qytetarëve, procesi ka qenë një kujtesë e vazhdueshme e plagëve të luftës dhe e debatit të papërfunduar për mënyrën se si ajo duhet të gjykohet dhe të kujtohet. Por, aktgjykimi i 16 shtatorit nuk është i formës së prerë. Mbrojtja ka të drejtë ta kundërshtojë vendimin në procedurën e apelit, çfarë do të thotë se beteja ligjore vazhdon. Për këtë arsye, rezultati përfundimtar i çështjes mbetet të përcaktohet.

OVLUÇK-ja, aksion para zyrave të BE-së: Gjykata Speciale po masakron të vërtetën

Në gjashtëvjetorin e arrestimit dhe transferimit në Hagë të liderëve të UÇK-së, në Prishtinë janë organizuar aktivitete të ndryshme nga veteranët e luftës dhe platforma qytetare “Liria ka emër”, ndërsa gjatë ditës janë përcjellë edhe reagime të shumta nga përfaqësues politikë dhe institucionalë lidhur me procesin gjyqësor në Dhomat e Specializuara. OVLUÇK-ja ka mbajtur një aksion simbolik para zyrave të Bashkimit Evropian në Prishtinë, përmes të cilit ka shprehur pakënaqësinë ndaj Gjykatës Speciale. Gjatë aksionit organizatorët kanë shpalosur një baner me mbishkrimin: “Serbia na masakroi popullin, Gjykata Speciale na masakroi të vërtetën!”, si dhe një mesazh drejtuar Evropës: “Evropë, u bënë gjashtë vjet që po e tradhton besimin e Kosovës në drejtësinë tënde!”.

Kryetari i OVLUÇK-së, Hysni Gucati, ka thënë se përmes këtij aksioni kanë dashur ta shprehin pakënaqësinë dhe mllefin ndaj kësaj gjykate, të cilën e konsideron të padrejtë dhe që, sipas tij, financohet nga Bashkimi Evropian.

Kurse kryetari i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Xhavit Jashari, ka thënë se aksioni është organizuar në shenjë solidarizimi me liderët e UÇK-së që po gjykohen në Hagë dhe familjet e tyre, duke kundërshtuar njëkohësisht bazën mbi të cilën është themeluar Gjykata Speciale.

Çitaku: Po punojmë për të krijuar një mbështetje më të plotë dhe të qëndrueshme juridike për liderët e UÇK-së

Ushtruesja e detyrës së kryetares së PDK-së, Vlora Çitaku, ka rikujtuar gjashtëvjetorin e arrestimit të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Ajo ka thënë se janë bërë gjashtë vjet që ata janë larg familjeve, lirisë dhe vendit për të cilin kanë dhënë gjithçka. “Aktgjykimi i shkallës së parë, me gjithsej 81 vjet burgim, është për ta thellësisht i padrejtë, ndërsa për ne krejtësisht i papranueshëm. E kundërshtojmë fuqishëm, sepse bie ndesh me provat, me standardet e një gjykimi të drejtë dhe me të vërtetën historike të luftës sonë çlirimtare. Në këtë proces nuk janë vënë në pikëpyetje vetëm katër çlirimtarë. Është vënë në pikëpyetje vetë historia e UÇK-së dhe rruga e Kosovës drejt lirisë e pavarësisë. Por historia jonë nuk fillon në sallat e gjyqit në Hagë. Dhe nuk mund të rishkruhet nga një aktgjykim!”, ka shkruar Çitaku në “Facebook”.






Ajo ka thënë se Kosova e lirë dhe e pavarur është rezultat i sakrificës së një populli të tërë, i luftës së shenjtë të UÇK-së dhe i mbështetjes vendimtare të aleatëve tanë, ShBA-së, vendeve evropiane dhe NATO-s. “Sot është koha që Republika e Kosovës t’i dalë zot historisë së vet dhe çlirimtarëve të saj. Angazhimi i përbashkët shtetëror, përtej dallimeve partiake, për hartimin e Strategjisë Shtetërore për procesin e apelit, forcimin e mbrojtjes juridike, sigurimin e mbështetjes së nevojshme financiare dhe intensifikimin e angazhimit diplomatik, është në funksion të kësaj mbrojtjeje. Paralelisht, po punojmë për plotësimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara, për të krijuar një mbështetje më të plotë dhe më të qëndrueshme juridike për çlirimtarët tanë”, ka shkruar Çitaku. Ajo ka shkruar se nuk po kërkojnë privilegje, por drejtësi dhe se nuk do të lejojnë që një aktgjykim ta shtrembërojë historinë e një populli që luftoi për liri. “Sepse Republika që lindi nga sakrifica e çlirimtarëve të saj, sot ka detyrimin të qëndrojë pranë tyre. Çlirimtarë, ju mbahuni të fortë! Ne nuk do t’ju lëmë kurrë vetëm! As sot. As nesër. Asnjëherë”, ka shtuar Çitaku.

“Liria ka emër” i dërgon letër Parlamentit Evropian, kërkon veprime urgjente lidhur me Specialen

Platforma qytetare “Liria ka emër” u ka dërguar një letër anëtarëve të Parlamentit Evropian në Bruksel përmes së cilës ka kërkuar shqyrtimin e shqetësimeve lidhur me funksionimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë dhe ndërmarrjen e veprimeve institucionale. Në letrën drejtuar eurodeputetëve, platforma ka kërkuar organizimin e një dëgjimi të posaçëm parlamentar, një vlerësim të pavarur ndërkombëtar dhe përgatitjen e një raporti të veçantë nga Komisioni Evropian dhe Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm (EEAS).

Ndër kërkesat e tjera janë edhe shqyrtimi i mekanizmave të financimit dhe mbikëqyrjes ndërkombëtare të Dhomave të Specializuara si dhe

ndërmarrjen e një nisme parlamentare përmes një rezolute, rekomandimi ose instrumenteve të tjera që do ta synonin forcimin e monitorimit të pavarur dhe garantimin e standardeve të gjykimit të drejtë.
Platforma "Liria ka emër" ka kërkuar gjithashtu një takim me përfaqësuesit e saj, me qëllim të paraqitjes së shqetësimeve, dokumentacionit dhe propozimeve për veprim institucional. Në letrën e saj, platforma "Liria ka emër" ka theksuar se Kosova e njeh rëndësinë e drejtësisë ndërkombëtare dhe parimin e përgjegjësisë individuale për krimet e provuara, por ka kërkuar që proceset gjyqësore të zhvillohen në përputhje me standardet universale të drejtësisë.
Më tutje, "Liria ka emër" ka ngritur çështjen e raportit të Dick Martyt, të miratuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës në vitin 2011, duke vënë në pah se pretendimet për trafikim të organeve, të cilat ishin pjesë e raportit, nuk figurojnë në aktakuzën ndaj ish-udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
Sipas "Liria ka emër", kjo mospërputhje ka krijuar shqetësime për transparencën dhe besueshmërinë e mekanizmit, ndaj platforma ka kërkuar sqarime institucionale lidhur me procesin që çoi në themelimin e tij. Në letër janë ngritur gjithashtu shqetësime për kohëzgjatjen e paraburgimit, barazinë e armëve ndërmjet Prokurorisë dhe Mbrojtjes, besueshmërinë e provave, pavarësinë dhe paanshmërinë gjyqësore, si dhe transparencën dhe llogaridhënien institucionale.
Platforma ka kërkuar edhe shqyrtimin e pretendimeve për konflikt të mundshëm interesi në prokurori, duke përmendur rastin e John Devaney, si dhe vlerësimin e praktikave për administrimin dhe pranimin e dëshmive. Shqetësimet e saj, sipas letrës, mbështeten në zhvillimet e proceseve gjyqësore, dokumentacionin publik dhe raportin e Bar Human Rights Committee of England and Wales (BHRC), të përgatitur në prill të vitit 2026 me kërkesë të Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës.
Në përfundim, "Liria ka emër" ka kërkuar që Parlamenti Evropian të mos mbetet vetëm vëzhgues i këtyre shqetësimeve, por t'i shfrytëzojë kompetencat e tij për të kërkuar transparencë, përgjegjësi dhe respektim të të drejtave themelore.



Konjufca: Punimet e grupit strategjik për Hagën do të jenë konfidenciale, qëllimi ynë është ta fitojmë rastin në Apel

Në gjashtëvjetorin e arrestimit dhe transferimit në Hagë të liderëve të UÇK-së, zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Glauk Konjufca, ka bërë me dije se punimet e grupit strategjik për hartimin dhe zbatimin e strategjisë shtetërore lidhur me procesin në Hagë do të jenë konfidenciale. Konjufca ka thënë se grupi është konstituuar javën e kaluar, janë përcaktuar edhe rregullat e punës dhe është themeluar grupi punues, i cili do t'i përmbledhë në një dokument të gjitha idetë dhe propozimet e institucioneve të përfaqësuara.
Konjufca ka njoftuar se takimi i ardhshëm do të mbahet nesër (e shtunë) dhe do të zgjasë disa orë. Gjatë tij pritet të shqyrtohen dhe të sintetizohen dokumentet e përgatitura nga institucionet e përfaqësuara në grup. Sipas Konjufcës, pas këtij takimi grupi punues do ta vazhdojë punën për hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse, zbatimi i së cilës do të jetë obligim për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës. Ai ka thënë se strategjia do të përfshijë disa dimensione, por ka kërkuar mirëkuptimin e medieve për natyrën konfidenciale të punimeve.
Konjufca ka theksuar se qëllimi i strategjisë është koordinimi i veprimeve shtetërore në procesin e apelit në Hagë, duke e cilësuar këtë çështje si të ndjeshme si në aspektin vendor, po ashtu edhe në atë ndërkombëtar. "Qëllimi është ta fitojmë rastin në procesin e apelit, që diskutohet aty, dhe qëllimet tona janë shumë të ndjeshme, edhe në kuptimin vendor, por edhe në kuptimin ndërkombëtar", ka deklaruar Konjufca.

Shqipe Mehmeti-Selimi: UÇK një herë, UÇK gjithmonë!

Deputetja Shqipe Mehmeti-Selimi ka reaguar në gjashtëvjetorin e arrestimit të bashkëshortit të saj, Rexhep Selimit, nga Zyra e Prokurorit të Specializuar. Duke shpërndarë një pjesë të fjalimit të Rexhep Selimit në Hagë, në të cilin ai ka thënë se është krenar që i ka dalë zot lirisë, Mehmeti-Selimi është shprehur se UÇK-ja do të jetë përgjithmonë. "UÇK n'Kosovë! UÇK n'Hagë! UÇK një herë, UÇK gjithmonë! 'Koha se kur do të kthehem në Kosovë tash e tutje varet nga vendimi juaj, por prokuroria duhet ta kish kuptuar se, kurdo që të kthehem, unë do të kthehem në Kosovën e lirë, në Kosovën për të cilën jam krenar që i kam dalë zot në kohën më të duhur dhe për lirinë e së cilës kam qenë dhe mbetem i gatshëm ta jap edhe jetën, sa herë që do të kërkohej nga unë'", ka shkruar Selimi në rrjetet sociale.

Krasniqi në gjashtëvjetorin e arrestimit të krerëve të UÇK-së: Po mbahen peng të një drejtësie të padrejtë

Deputeti i PDK-së dhe djali i Jakup Krasniqit, Altin Krasniqi, ka reaguar në gjashtëvjetorin e arrestimit të liderëve UÇK-së, duke kritikuar Gjykatën Speciale dhe procesin gjyqësor ndaj tyre. Krasniqi ka deklaruar se Kosova nuk e ka fituar lirinë duke pritur që dikush t'ia dhuronte, ndërsa ka shprehur qëndrimin se liderët e UÇK-së po përballen me një proces që, sipas tij, lidhet edhe me pozitat politike që kanë mbajtur. Ai ka pretenduar se Gjykata Speciale nuk po i gjykon katër liderët për veprimet e tyre individuale, por për postet politike që kanë pasur. Në reagimin e tij, deputeti i PDK-së ka përmendur edhe prokurorin Jack Smith, duke kritikuar deklarimet e tij lidhur me përgjegjësinë e ish-drejtuesve të UÇK-së dhe strukturat e organizatës. "Jo rastësisht Smith këmbëngulte që drejtoria politike e UÇK-së ishte organ mbi organet tjera. Jo rastësisht duan t'i bëjnë përgjegjës personat që në një mënyrë apo tjetër ishin të lidhur me shtabin e UÇK-së. Pasojat e 16 shtatorit nuk ndihen tani, por vetëm pas një kohe të gjatë", ka deklaruar Krasniqi. Ai ka shtuar se, pavarësisht prej deklarimit të Smithit se UÇK-ja nuk ishte në gjyq, përmbajtja e fjalës së tij prej rreth 90 minutash, sipas Krasniqit, e kundërshtonte këtë qëndrim.



AKSION KUNDËR BIXHOZIT ILEGAL NË PRIZREN, SUHAREKË DHE DRAGASH, ARRESTOHEN 22 PERSONA

PRIZREN, 5 NËNTOR - Policia e Kosovës, në koordinim me Prokurorinë Themelore në Prizren, ka realizuar një operacion të gjerë kundër organizimit të lojërave të paligjshme të fatit në rajonin e Prizrenit. Operacioni është zhvilluar më 4 nëntor 2026 në kuadër të planit operativ "Bixhozi", pas një periudhe të gjatë të veprimeve operative-hetimore, përfshirë edhe masa të veçanta hetimore.

Gjatë aksionit janë kontrolluar 20 lokacione, përkatësisht lokale afariste dhe shtëpi banimi, në tri komuna: Prizren, Suharekë dhe Dragash. Sipas njoftimit të policisë, gjatë kontrolleve janë sekuestruar rreth 10 mijë euro para të gatshme, pajisje të ndryshme elektronike, si dhe katër armë zjarri dhe municion.

Në kuadër të këtij operacioni janë arrestuar 22 persona, të dyshuar për veprën penale "Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm", sipas nenit 294, paragrafi 2, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Pas intervistimit, në prani të avokatëve mbrojtës dhe me vendim të Prokurorisë, 19 të dyshuar janë ndaluar për 48 orë, ndërsa tre të tjerë janë liruar dhe ndaj tyre do të vazhdojë procedura e rregullt.

Operacioni është udhëhequr nga Prokuroria Themelore në Prizren dhe është realizuar nga Sektori Rajonal i Hetimeve në kuadër të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Prizren, me mbështetjen e njësive dhe stacioneve të tjera policore.

Prokuroria Themelore në Prizren dhe Policia e Kosovës kanë bërë me dije se do ta vazhdojnë angazhimin për parandalimin dhe luftimin e veprimtarive kriminale, përfshirë organizimin



e bixhozit të kundërligjshëm.

Po ashtu, Prokuroria Themelore në Prizren - Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve B. K. dhe F. S., (i cili gjendet në arrati), për shkak të dyshimit të bazuar mirë se, në bashkëkryerje, kanë kryer veprën penale "Fajdeja" nga neni 331 i KPRK-së, si dhe kundër të pandehurit H. T., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale "Manipulimi me prova" nga neni 389 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Sipas aktakuzës, të pandehurit B. K. dhe F. S., duke shfrytëzuar gjendjen e rëndë financiare dhe papërvojën e të dëmtuarit L. S., kanë dhënë hua në shuma të ndryshme parash, duke vendosur kamata dhe provizione mujore dukshëm jo proporcionale me shumat e huazuara.

Në këtë mënyrë, përmes marrëveshjeve të njëpasnjëshme të huadhënies dhe kërkesave për pagesën e detyrimeve, të pandehurit kanë përfituar shuma të konsiderueshme pasurore, ndërsa të dëmtuarve L. S. dhe babait të tij M. S. u kanë shkaktuar dëm në shumën prej 140 000 eurosh.

KOMF-i I KËRKON KURTIT RREGULLIMIN E FINANCIMIT PËR SHËRBIMET SOCIALE PËRMES THEMELIMIT TË GRANTIT SPECIFIK PËR SHËRBIMET SOCIALE

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF), i cili përfaqëson 34 organizata joqeveritare, dhe Asociacioni i Qendrave për Punë Sociale, i kanë drejtuar një kërkesë kryeministrit Albin Kurti për adresimin e një prej mangësive më kritike strukturore të sistemit aktual të mbrojtjes sociale: financimin e pamjaftueshëm dhe të paqëndrueshëm të shërbimeve sociale. "Pavarësisht progresit në zhvillimin e kornizës ligjore, niveli aktual i financimit mbetet shumë prapa nevojave reale të fëmijëve dhe familjeve. Pa financim të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm, reforma e mbrojtjes sociale nuk mund të zbatohet në mënyrë efektive", thuhet në kërkesën e tyre, duke shtuar se komunat kanë përgjegjësinë për sigurimin dhe ofrimin e një game të gjerë të shërbimeve sociale dhe të mbrojtjes së fëmijëve, megjithatë shumë prej tyre nuk kanë kapacitetin financiar dhe gatishmërinë për të siguruar ofrimin e shërbimeve. "Si pasojë, shërbimet parandaluese dhe shërbimet për mbrojtjen nga dhuna dhe abuzimi, mbështetjen e familjeve në situata krize, etj, ofrohen nën kufizime të mëdha financiare. Në këtë kontekst, kërkojmë që Qeveria të shqyrtojë krijimin e Grantit Specifik të dedikuar për Shërbimet Sociale, në kuadër të Projekt Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal me qëllim të rregullimit të mekanizmit për financimin e shërbimeve sociale dhe konsiderojmë që kjo duhet të trajtohet si përgjegjësi urgjente publike dhe të reflektohet në Buxhetin e vitit 2027. Një mekanizëm i tillë do të mundësonte financim të qëndrueshëm, transparent, të barabartë dhe të bazuar në nevoja, duke reduktuar pabarazitë ndërmjet komunave në ofrimin e shërbimeve sociale", është thënë në këtë kërkesë.

Sipas KOMF-it, rastet e fundit tragjike, na përballin edhe një herë me një të vërtetë të dhimbshme: ligjet dhe mekanizmat e mbrojtjes nuk mjaftojnë nëse nuk shoqërohen me shërbime funksionale, profesionistë të mjaftueshëm, përgjigje të koordinuar nga institucionet dhe rritje të llogaridhënies. "Financimi i mbrojtjes sociale mbetet kryesisht i përqendruar në transfere monetare, ndërsa shërbimet sociale, si ndërhyrje profesionale që parandalojnë përshkallëzimin e krizave dhe adresojnë cenueshmërinë e familjeve, vazhdojnë të marrin një pjesë dukshëm më të vogël të buxhetit. Në vitin 2024, Kosova shpenzoi rreth 854.6 milionë euro për mbrojtjen sociale, ndërsa shërbimet sociale përbënin vetëm rreth 1.6 % të shpenzimeve të sektorit. Ky disproporcion tregon nevojën për një qasje më të balancuar, që krahas mbështetjes përmes transfereve monetare, investon më shumë në parandalim dhe shërbime profesionale për fëmijët dhe familjet", është thënë në kërkesën e këtij koalicioni.

KOMF-i thekson se 38 Qendra për Punë Sociale dhe rreth 50 organizata joqeveritare të licencuara janë në vijën e parë të ofrimit të shërbimeve sociale, megjithatë, ato përballen me kufizime të mëdha në burime



njerëzore dhe financim. "Qendrat për Punë Sociale vazhdojnë të jenë të mbingarkuara me reagim në raste emergjente, ku aktualisht, një zyrtar nga QPS në komunat e mëdha ka rreth 350 lëndë aktive në vit. Organi i Kujdestarisë në shumicën e komunave nuk është i kompletuar me 5 profesionistët sipas kërkesës ligjore dhe nuk është funksional.

Në anën tjetër, organizatat e licencuara që ofrojnë shërbime sociale për fëmijët dhe familjet në situata të cenueshme, përfshirë fëmijët pa kujdes prindëror, fëmijët viktima të abuzimit dhe dhunës, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët në situatë rruge, fëmijët e përfshirë në punë të rënda dhe të rrezikshme, fëmijët përdorues të drogave, si dhe kategori të tjera të fëmijëve dhe familjeve në nevojë për mbrojtje, përballen vazhdimisht me rrezikun e reduktimit apo ndërprerjes së shërbimeve për shkak të mungesës së financimit të qëndrueshëm", është thënë në kërkesën e KOMF-it, duke theksuar se kjo situatë rrezikon ta cenojë vazhdimësinë e shërbimeve thelbësore dhe jetike për këta fëmijë dhe familjet e tyre, duke ndikuar drejtpërdrejt në mirëqenien, sigurinë dhe mbrojtjen e tyre.

Tutje thuhet se, sipas analizave financiare, aktualisht nga buxheti i shtetit ndahen rreth 20 milionë euro në vit për shërbimet sociale. "Për të përballuar kërkesat në rritje për shërbime, si dhe për të përmbushur kërkesat e legjislacionit dhe standardet minimale për ofrim të shërbimeve sociale, vlerësohet se nevojitet një financim shtesë prej 16 milionë eurosh në vit. Kjo do ta çonte financimin e përgjithshëm për shërbimet sociale në rreth 36 milionë euro në vit, ose afërsisht 0.4% të buxhetit të Kosovës për vitin 2026. Ky investim do të përbënte një pjesë relativisht modeste të buxhetit të përgjithshëm, ndërsa do të mundësonte fuqizimin e parandalimit dhe ndërhyrjes së hershme, si dhe reduktimin e kostove shumë më të larta sociale dhe ekonomike që lidhen me dhunën ndaj fëmijëve, ndarjen e familjeve, kujdesin institucional, traumën e patrajtuar dhe përjashtimin social", është thënë në këtë kërkesë.

Për adresimin e sfidave sistemore në financimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale, KOMF-i ka vlerësuar të nevojshme që qeveria të ndërmarrë këto ndërhyrje: Të alokojë buxhetin e nevojshëm për punësimin e 200 zyrtarëve të shërbimeve sociale (me fokus psikologë klinik) në kuadër të Qendrave për Punë Sociale, me qëllim të plotësimit të kërkesave minimale ligjore për funksionalizimin e Organeve të Kujdestarisë, si dhe sigurimin e infrastrukturës dhe mjeteve logjistike, me qëllim të mundësimit të ofrimit të shërbimeve cilësore e në kohë për qytetarët; Të rrisë buxhetin e dedikuar për thirrjen publike për organizatat e licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale, me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së këtyre shërbimeve dhe zgjerimit të mbështetjes për fëmijët dhe familjet në nevojë; Të miratojë Grantin Specifik për Shërbimet Sociale në kuadër të Projekt Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, për të siguruar financim të barabartë, transparent dhe të bazuar në nevoja; Të finalizojë kostimin dhe formulën e alokimit për themelimin dhe operacionalizimin e Grantit, duke marrë parasysh numrin e fëmijëve dhe qytetarëve, nevojat dhe kapacitetin e komunave.

RAPORTI PËR KOSOVËN I KOMISIONIT EVROPIAN VËRTETON PRESIONET E QEVERISË NDAJ GAZETARËVE DHE MEDIEVE

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Në raportin vjetor të Komisionit Evropian për zgjerimin, shqetësues vazhdon të mbetet mospërparimi në lirinë e medias dhe shprehjes në Kosovë.
Raporti e identifikon kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, si një nga zyrtarët e lartë që përdor gjuhë të ashpër në raport me mediet dhe gazetarët dhe bën thirrje për ndaljen e një retorike të tillë. "Gjatë periudhës së raportimit janë regjistruar 35 raste të sulmeve fizike dhe verbale apo të kërcënimeve ndaj gazetarëve, një rënie e konsiderueshme krahasuar me vitin paraprak. Sulmet përfshinin pengimin e punës së gazetarëve nga zyrtarët e sigurisë, si dhe akuzat dhe gjuhën e ashpër të përdorur nga zyrtarë të lartë qeveritarë (përfshirë Kryeministrin) ndaj gazetarëve dhe medieve. Zyrtarët publikë duhet të përmbahen nga përdorimi i retorikës që shënjestron ose diskrediton gazetarët, ndërsa sulmet dhe frikësimi i tyre duhet të dënohen. Një kameraman u arrestua dhe u mbajt për një kohë të shkurtër në paraburgim nga Policia e Kosovës, ndërsa të paktën katër persona u ndaluan për kërcënimin e gazetarëve. Rastet e frikësimit përfshinin gjithashtu ngacmimin në internet dhe shpërndarjen e të dhënave personale", thuhet në një pjesë të raportit.
Në raport bëhet thirrje gjithashtu për miratimin e një ligji të ri për Radio Televizionin e Kosovës dhe atij të KPM-së, kurse përshëndetet miratimi i strategjisë së re të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që u jep prioritet trajtimit të rasteve të gazetarëve.
AGK-ja e sheh këtë raport si pasqyrim real të ambientit të



rëndë të të bërit gazetari në Kosovë dhe bën sërish thirrje për ndalimin e sulmeve në drejtim të gazetarëve dhe respektimin e punës së tyre në interes të publikut.
Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe mbeten kryesisht të vlefshme.
Gjatë vitit të ardhshëm Kosova duhet të: Vazhdojë përmirësimin e kapaciteteve të autoriteteve të prokurorisë, gjyqësorit dhe organeve të zbatimit të ligjit për trajtimin e rasteve që lidhen me dhunën dhe kërcënimet ndaj gazetarëve dhe punonjësve të tjerë të mediave; Hartojë protokolle dhe organizojë trajnime për mbrojtjen dhe sigurinë e gazetarëve, duke përfshirë mekanizmat e paralajmërimit të hershëm dhe reagimit të shpejtë; të nisë një dialog të strukturuar me përfaqësuesit e mediave; të përmirësojë kushtet e punës së gazetarëve dhe punonjësve të mediave, si dhe të forcojë raportimin profesional; Miratojë një Ligj të ri për Komisionin e Pavarur të Mediave, plotësisht në përputhje me legjislacionin e BE-së (acquis të BE-së) dhe standardet evropiane; të rishikojë Ligjin për Radio Televizionin e Kosovës, me qëllim sigurimin e financimit të qëndrueshëm, si dhe të sigurojë financim në përputhje me ligjin aktual, duke ruajtur pavarësinë e transmetuesit publik.

10 VJET NGA VDEKJA E ASTRIT DEHARIT, KURTI: ENDE NUK E DIMË EMRIN E VRASËSIT TË TIJ

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bërë homazhe te varri i aktivistit të Lëvizjes Vetëvendosje, Astrit Dehari, në 10-vjetorin e vdekjes.
I shoqëruar nga prindërit, bashkëshortja, vajza dhe familjarë të tjerë të Deharit, Kurti ka vendosur lule të freskëta te varri i tij, duke kërkuar zbardhjen e rastit dhe vënien e drejtësisë.
Kurti ka deklaruar se, dhjetë vjet pas vdekjes së Deharit, ende nuk është zbardhur e vërteta dhe nuk ka persona të ndëshkuar për këtë rast. "10 vjet pa Astritin janë shumë, janë shumë për familjen, për Vetëvendosjen, për të gjithë ne që e njohëm, por janë edhe shumë për Kosovën dhe shqiptarët, sepse mungon e vërteta e mbytjes së tij dhe drejtësia. 10 vjet më vonë nuk e dimë emrin e vrasësit të Astritit", ka thënë Kurti.



Ai ka rikujtuar se lidhur me rastin e Deharit janë ndërruar pesë prokurorë, ndërsa ka kritikuar institucionet përgjegjëse për deklaratat e dhëna në orët e para pas vdekjes së tij, më 5 nëntor 2016, në Qendrën e Paraburgimit në Prizren. Sipas Kurtit, deklarimet e institucioneve para përfundimit të hetimeve e kanë rënduar edhe më shumë situatën, ndërsa deri më tani askush nuk është akuzuar, arrestuar apo dënuar lidhur me vdekjen e Deharit. "Pesë prokurorë janë ndërruar për rastin e tij dhe qysh në orët e para pas mbytjes së tij, të shtunën e 5 nëntorit 2016, u patën nxituar institucionet përgjegjëse të japin konstatime para hetimeve. Kjo e rëndoi shumë situatën dhe kjo situatë e rënduar vazhdoi sot e asaj dite, pasi askush nuk është akuzuar, askush s'është arrestuar, gjykuar e dënuar për mbytjen e Astritit", ka deklaruar Kurti. Ai ka theksuar se kërkesa për drejtësi do të vazhdojë edhe në përvjetorët e ardhshëm. "Edhe në këtë përkujtim Astriti na mungon dhe nuk do të ndalemi pa kërkuar drejtësi për të", ka thënë Kurti.
Ndërsa babai i Astrit Deharit, Avni Dehari, ka thënë se dhjetë vjet pritje për zbardhjen e rastit përbëjnë një periudhë të rëndë për familjen, duke shprehur pakënaqësinë e tij për mënyrën se si janë zhvilluar hetimet. "Si prind i Astritit i bashkëngjitem fjalës së kryeministrit. Dhjetë vjet nga vrasja e tij janë shumë për t'u zbardhur drejtësia. Dhjetë vjet janë torturë për ne si familje, për të pritur se çfarë do të ndodhë me këtë rast që ende nuk po përmbyllet", ka deklaruar Dehari.
Ai e ka kritikuar Prokurorinë për zvarritjen e hetimeve, duke thënë se që nga fillimi ka pasur veprime dhe deklarime që, sipas tij, kanë ndikuar negativisht në proces. "Dhjetë vjet janë shumë që Prokuroria, që nga fillimi, me shumë bashkëveprimtarë të tyre, e kanë zvarritur këtë hetim deri në skajshmëri. Që nga fillimi prononcimet për medie, konstatimet kanë qenë qëllimkëqija, edhe pse ka pasur hetime nga Këshilli i Pavarur Ligjor. Presim që në të ardhmen ky rast të trajtohet më seriozisht dhe të kemi rezultate", ka thënë Avni Dehari.
Astrit Dehari vdiq më 5 nëntor 2016 derisa ndodhej në Qendrën e Paraburgimit në Prizren. Dhjetë vjet pas vdekjes së tij, familja dhe përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje vazhdojnë të kërkojnë zbardhjen e plotë të rastit dhe vënien e drejtësisë.

PESË KADETË TË FSK-së DIPLOMOHEN NË AKADEMITË USHTARAKE TË GJERMANISË, MAQEDONCI MERR PJESË NË CEREMONI

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, mori pjesë në ceremoninë e diplomimit të kadetëve të FSK-së, të organizuar në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Berlin. Kadetët përfunduan me sukses studimet trevjeçare në akademitë ushtarake të Republikës Federale të Gjermanisë.
Në këtë ceremoni morën pjesë edhe përfaqësues të Ministrisë Federale të Mbrojtjes dhe të Forcave të Armatosura të Gjermanisë, duke dëshmuar rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet dy vendeve në fushën e mbrojtjes.
Me këtë rast, ministri shprehu urimet për kadetët e diplomuar: Xheto Kelmendin, në fushën e këmbësorisë; Leutrim Nikën, në logjistikë; Gentri Azemin, në IT ushtarake; si dhe Lavdim Sylejmanin dhe Betim Elshanin, në polici ushtarake.
Pasi përfunduan studimet, oficerët e rinj do t'u bashkohen radhëve të trupës së oficerëve të Ushtrisë së Kosovës, duke vënë në shërbim të Republikës së Kosovës njohuritë, përvojën dhe përgatitjen profesionale të fituar gjatë studimeve. Deri më tani 18 kadetë të FSK-së kanë përfunduar studimet në akademitë ushtarake të Gjermanisë, ndërsa 16 të tjerë janë duke vijuar studimet në



akademi të ndryshme ushtarake gjermane. Po ashtu, përmes programit Military Training Assistance, mbi 80 pjesëtarë të FSK-së kanë përfituar nga trajnime të ndryshme në Gjermani.
Ministri Maqedonci shprehu mirënjohje dhe falënderim për Ministrinë Federale të Mbrojtjes së Gjermanisë për mbështetjen dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm. Ndërsa kadetëve të diplomuar u uroj suksese në rrugëtimin e tyre profesional dhe në përmbushjen e misionit në shërbim për Republikën e Kosovës.
Bashkëpunimi me Republikën Federale të Gjermanisë përbën një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e kapaciteteve profesionale, avancimin e arsimit dhe trajnimit ushtarak si dhe në forcimin e mëtejmë të kapaciteteve mbrojtëse të vendit tonë.

Kosova dhe Sllovenia synojnë zgjerimin e bashkëpunimit ekonomik, në fokus edhe energjia

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka pritur të mërkurën në takim ambasadorin e Sllovenisë në Kosovë, Borut Blaj, me të cilin ka diskutuar për avancimin e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet dy vendeve.

Ambasadori i uroi suksese ministres Rizvanolli në mandatin e saj dhe rikonfirmoi përkushtimin e Sllovenisë për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me Kosovën. Ai theksoi se funksionalizimi i plotë i institucioneve dhe stabiliteti politik krijojnë kushte të favorshme për avancimin e nismave të përbashkëta dhe zgjerimin e bashkëpunimit ekonomik.

Gjatë takimit u vlerësua bashkëpunimi i deritanishëm, veçanërisht në fushën e tregtisë, si dhe u diskutuan mundësitë për zgjerimin e tij në sektorë të tjerë, veçanërisht në energji.

Bashkëbiseduesit diskutuan edhe për organizimin e edicionit të dytë të "Slovenia-Kosovo Business Day", i cili do të mbahet në fund të muajit nëntor. Kjo ngjarje pritet të sjellë në Kosovë përfaqësues të kompanive sllovene dhe të krijojë mundësi të reja bashkëpunimi në fusha ku marrëdhëniet ekonomike ndërmjet dy vendeve janë më të zhvilluara, përfshirë bujqësinë, teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, tregtinë, mjekësinë dhe energjinë.

Ministrja Rizvanolli falënderoi ambasadorin për angazhimin e tij në forcimin e lidhjeve ekonomike ndërmjet Kosovës dhe Sllovenisë. Ajo e njoftoi atë për zhvillimet më të fundit në sektorin e energjisë, përfshirë ankandet që janë duke u zhvilluar për kapacitetet e reja në energji të ripërtërishme.



Me këtë rast, ministrja Rizvanolli ftoi kompanitë sllovene të marrin pjesë në ankandet e ardhshme, duke theksuar se Kosova po krijon mundësi të reja investimi në sektorin e energjisë së pastër dhe se ekspertiza e kompanive sllovene do të ishte e mirëpritur në këto procese.

KOMISIONI EVROPIAN VLERËSON PËRPARIMIN E REFORMAVE NË SEKTORIN FINANCIAR DHE KONFIRMON QËNDRUESHMËRINË E SEKTORIT BANKAR NË KOSOVË

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) mirëpret vlerësimet e Komisionit Evropian në Raportin për Kosovën për vitin 2026, i cili konfirmon qëndrueshmërinë e sektorit bankar dhe njeh përparimin e arritur në avancimin e reformave ligjore, rregullative dhe institucionale në sektorin financiar, në përputhje me standardet dhe praktikat e Bashkimit Evropian (BE).

Raporti vlerëson përparimin e mirë të Kosovës në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit (Kapitulli 4), duke theksuar miratimin e legjislacionit për shërbimet e pagesave dhe për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Përfshirja e dispozitave për Bankimin e Hapur (Open Banking) në Ligjin për Shërbimet e Pagesave është vlerësuar përparim pozitiv në digjitalizimin e shërbimeve financiare. Komisioni Evropian konstaton se rekomandimet e vitit paraprak në këtë fushë janë zbatuar në masë të madhe, duke njohur kështu përparimin në përafrimin e kornizës ligjore me kërkesat e BE-së.

Në fushën e shërbimeve financiare (Kapitulli 9), Raporti evidenton përparimin në përafrimin e legjislacionit bankar me standardet evropiane, veçanërisht lidhur me kërkesat për kapital, rimëkëmbjen dhe zgjidhjen e bankave.

Në këtë drejtim vlerësohen zhvillimet në kornizën ligjore dhe institucionale, përfshirë përcaktimin e BQK-së si autoritet përgjegjës për zgjidhjen e bankave dhe hapat drejt operacionalizimit të këtij funksioni.

Komisioni Evropian konfirmon se sektori bankar i Kosovës ka vazhduar të zgjerohet duke mbetur i shëndoshë dhe i qëndrueshëm, me tregues të kënaqshëm të kapitalizimit, cilësisë së aseteve dhe performancës financiare. Sipas të dhënave të përfshira në Raport, në fund të qershorit 2026, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit ishte 17.1 %, ndërsa niveli i kredive joperformuese ishte 2.0 %, duke dëshmuar qëndrueshmërinë e sektorit bankar dhe kapacitetin e tij për ta mbështetur aktivitetin ekonomik.

Raporti njeh gjithashtu përparimin në zbatimin e udhërrëfyesit për Procesin e Rishikimit dhe Vlerësimit Mbikëqyrës (SREP), si pjesë e kalimit drejt mbikëqyrjes së plotë të bazuar në rrezik deri në fund të vitit 2027. Ky zhvillim pasqyron angazhimin e BQK-së për avancimin e praktikave mbikëqyrëse dhe forcimin e



mëtejmë të qëndrueshmërisë së sistemit financiar.

Në fushën e sistemeve të pagesave, Komisioni Evropian njeh përparimin e arritur përmes miratimit të Ligjit për Shërbimet e Pagesave, i cili avancon përafrimin me direktivat dhe rregulloret përkatëse të BE-së. Kjo reformë përbën një bazë të rëndësishme për zhvillimin e shërbimeve moderne të pagesave, nxitjen e konkurrencës dhe inovacionit, si dhe për avancimin e integrimit financiar të Kosovës në tregun evropian, përfshirë përgatitjet për aplikim në Zonën e Vetme të Pagesave në Euro (SEPA) dhe zhvillimin e infrastrukturës për pagesa të shpejta.

Në kuadër të politikës ekonomike dhe monetare (Kapitulli 17), Raporti evidenton përpjekjet e vazhdueshme të BQK-së për forcimin e qeverisjes institucionale dhe transparencës, në funksion të avancimit të mëtejmë të kornizës së saj institucionale.

Guvernatori i BQK-së, Ahmet Ismaili, thekson se vlerësimet e Komisionit Evropian përbëjnë një njohje të rëndësishme të përparimit të reformave të ndërmarra dhe të përkushtimit institucional për ruajtjen e stabilitetit financiar dhe përafrimin me standardet evropiane. "Vlerësimet e Komisionit Evropian konfirmojnë qëndrueshmërinë e sektorit bankar dhe njohin përparimin e reformave që po zbatojmë në kuadër të mandatit të BQK-së. Avancimi i mbikëqyrjes së bazuar në rrezik, modernizimi i kornizës ligjore dhe rregullative, zhvillimi i sistemeve të pagesave dhe forcimi i kapaciteteve institucionale mbeten prioritete të rëndësishme të punës sonë. Jemi të përkushtuar ta vazhdojmë zbatimin e reformave dhe adresimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian, duke ruajtur pavarësinë institucionale dhe duke kontribuar në integrimin financiar dhe ekonomik të Kosovës në Bashkimin Evropian", theksoi Guvernatori Ismaili.

BQK-ja ka theksuar se mbetet e përkushtuar ndaj zbatimit të Planit të saj Strategjik, forcimit të mëtejmë të mbikëqyrjes dhe stabilitetit financiar, avancimit të kornizës për rimëkëmbjen dhe zgjidhjen e bankave, zhvillimit të tregut të sigurimeve, modernizimit të sistemeve të pagesave dhe forcimit të qeverisjes institucionale.

Në këtë drejtim, BQK-ja do ta vazhdojë bashkëpunimin me institucionet vendore, Komisionin Evropian dhe partnerët ndërkombëtarë për adresimin e rekomandimeve të Raportit dhe avancimin e reformave që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit financiar dhe integrimin evropian të vendit.

Strategjia e Inovacionit të Kosovës: Në hap me prioritetet vendore, rajonale dhe evropiane

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Në Institutin Riinvest të enjten u paraqit analiza e Strategjisë së Inovacionit 2030+, duke shqyrtuar përafrimin e saj me strategjitë dhe prioritetet e tjera kombëtare, rajonale dhe evropiane.

Gjatë diskutimit me palët e interesuara u theksua rëndësia e zbatimit efektiv të dokumenteve strategjike si udhërrëfyes për zhvillimin e inovacionit dhe shkencës në Kosovë, si dhe nevoja për koordinim më të mirë të politikave në fusha të ndërlidhura, përfshirë shkencën, industrinë, digjitalizimin dhe administratën publike.

Pjesëmarrësit theksuan gjithashtu nevojën për forcimin e rolit të akademisë në zhvillimin e inovacionit, përmes krijimit të stimujve për kërkime shkencore me zbatueshmëri në industri dhe bashkëpunimit më të ngushtë me sektorin privat.

Njëkohësisht, u diskutua rëndësia e përmirësimit të qasjes në financim dhe krijimit të kushteve më të favorshme për zhvillimin dhe zbatimin e ideve inovative.

Gjetjet dhe rekomandimet nga diskutimi do të kontribuojnë në hartimin e një dokumenti të rekomandimeve për politika (Policy Brief), në kuadër të projektit POLICY ENLARGE, të financuar nga programi Horizon Europe i Bashkimit Evropian.



SI U BËNË BITËLSAT MË TË MËDHENJ SE SHEKSPIRI

Pasi e kanë lënë në hije Bardin, një atraksion i ri gjigant në Liverpul synon të vendosë Katërshen Fantastike [Fab Four] si forcën më fitimprurëse kulturore të Britanisë.



The Telegraph

Beatles tani janë një nga kartëvizitat më të mëdha kulturore të Britanisë, duke e kaluar madje edhe Shekspirin [William Shakespeare] kur bëhet fjalë për peshën artistike të vendit. Duhet pranuar se, në terma financiarë, grupi mund të jetë ende pas franshizës së Heri Poterit [Harry Potter]. Por, me Britaninë që tani po bëhet gati për Bitëlmaninë 2.0 [Beatlemania 2.0], mund të mos kalojë shumë kohë para se Katërshja Fantastike t'i bëjnë konkurrencë serioze Djaloshit Magjistar.

Ish-selia e [kompanisë së grupit] Apple Corps në Londër, vendi i koncertit të tyre të famshëm në çati në vitin 1969, hapet për publikun vitin e ardhshëm, ndërsa viti 2028 sjell daljen e filmave biografikë - për të katër anëtarët - për ekranin e madh të [regjisorit] Sam Mendesit.

Megjithatë, edhe këto projekte zbehen në krahasim me sipërmarrjen e shpallur së fundmi nga Apple Corps - një atraksion i madh për vizitorët në qendër të Liverpulit që po quhet Grejslendi [Graceland] ose Dolivudi [Dollywood] i Britanisë - sipas vendeve turistike amerikane kushtuar Elvis Presleyt dhe Dolly Partonit. Ky do të jetë projekti më i madh i lidhur me bitëlsat deri më tani dhe Paul McCartney e ka përshkruar si "të jashtëzakonshëm."

Atraksioni që do të hapet në vitin 2028, do të bëjë që Apple Corps-i, që menaxhon çështjet komerciale të grupit, ta marrë përsipër, ta zhvendosë dhe ta zgjerojë muzeun ekzistues "Beatles Story" i cili ndodhet në Liverpul. Versioni i ri do të zërë plot 9290.3 metra katrorë. Organizatorët premtojnë se "përvoja e re" do të përfshijë fëmijërinë e anëtarëve të grupit në Liverpul, në Hamburg, në lokalin "The Cavern Club," në studion "Abbey Road" dhe më shumë ...

Kjo na çon te Shekspiri. Sot, Beatles janë ndoshta simbol më i madh i Britanisë edhe se vetë Bardi.

Në vitin 2007, studiuesit në një konferencë në Universitetin e Lidsit argumentuan se albumi i bitëlsave, Sgt Pepper's Lonely Hearts Club Band, i kishte kaluar dramat e Shekspirit si pikë e referencës kulturore globale. Kjo ishte 19 vjet më parë.

Tani i kanë arritur edhe financiarisht. Sipas të dhënave të fundit nga Trusti i Vendlindjes së Shekspirit [Shakespeare Birthplace Trust] 32 për qind e vizitorëve në Stratford [Stratford-upon-Avon] shkojnë atje posaçërisht për një atraksion të lidhur me Shekspirin. Vlera e përgjithshme e turizmit në Stratford është 250 milionë paundë në vit [afro 300 milionë euro], çka sugjeron se Bardi përbën 80 milionë paundë [afro 96 milionë euro] të kësaj shume.

Ndërkohë, një studim i vitit 2015 zbuloi se Beatles i sjellin Liverpulit 81.9 milionë paundë në vit [98.2 milionë euro]. "Që atëherë është rritur," thotë David Bedford, guidë turistike vendase dhe autor librash për bitëlsat. Natyrisht, ky krahasim disi i thjeshtuar nuk përfshin as morinë e dramave të Shekspiriti që vihen në skenë në mbarë botën, as milionat e këngëve të grupit Beatles që dëgjohen përmes transmetimit çdo javë. Megjithatë, Beatles fitojnë me një epërsi të vogël. (Lennoni pa dyshim do të buzëqeshte me ironi, pasi dikur deklaroi në mënyrë të famshme: "E urrej Shekspirin.")

Pra, pasi e kanë kaluar dramaturgun më të famshëm në botë, a mund ta ketë Apple Corps-i synimin ta rrëzojë Heri Poterin nga vendi i forcës më fitimprurëse kulturore të Britanisë?

David Hepworth, autor, mendon se po. "Nuk them se po mendojnë për Shekspirin, por duke gjykuar nga përvoja e ekipit të ri drejtues në Apple, mund të jenë duke menduar për Hari Poterin," thotë ai. "Çfarë do të doja unë? Nuk kishte asnjë ditë të vetme gjatë kohës kur Beatles ishin bashkë që të mos bënin diçka që ia vlente të përmendej. Do të doja të shihja një ekspozitë që do ta pasqyronte këtë."

Çuditërisht, një "Beatles Story" krejtësisht i ri do të jetë atraksioni i parë për grupin në Liverpul që drejtohet nga Apple. Asnjë nga 220 muzetë, dyqanet, ambientet dhe turet ekzistuese që për tematikë kanë grupin, nuk e përfshijnë kompaninë e cila mbikëqyr interesat e bitëlsave.

"Kanë qenë të gjithë operatorë të pavarur që kanë bërë punën e tyre," shpjegon Bedford. Ndonëse atraksioni do të përbëjë një "konkurrencë të madhe," ai shton se do të jetë "i mrekullueshëm" për Liverpulin. "Një gjë që mund ta garantoni është se, nëse po e bën Apple, atëherë do ta ketë miratimin e Paulit, Ringos, Olivias dhe Yokos [të vejave të George Harrisonit dhe John Lennonit]. Në këtë rast, nuk do të bëhet tepër qesharak. Nuk do të jetë pa shije."

Andy Burnham sigurisht që shpreson që jo. "Një shtesë e klasit botëror për Liverpulin" është mënyra se si kryeministri e përshkroi atraksionin. Me fjalë të tjera, Burnhami e sheh Dolivudin liverpulas si magnet për turistët dhe si simbol të fuqisë së butë kulturore të Britanisë.

Por, vetëm gjatë dekadave të fundit Apple Corps ka lëvizur drejt shndërrimit në të ardhura të trashëgimisë së grupit të saj më të madh. Kjo sepse nga vitet 1970-1990, kompania ishte e zënë me "përvoja" të një lloji dukshëm më të rrëmujshëm.

E themeluar në vitin 1968, Apple Corps fillimisht duhej të mbikëqyrte shpërbërjen e zgjatur të grupit - të njoftuar në vitin 1970, por të përfunduar ligjërisht vetëm në fund të vitit 1974. Kompania kaloi një pjesë të viteve '80 të shekullit XX duke kërkuar honorarë nga shtëpia diskografike EMI (dhe përsëri në vitin 2005), pastaj duke u përballur me Apple Computer për të drejtat mbi emrin dhe logon. Neil Aspinall, ish-drejtuesi i Apple Corps-it, ndërtoi gjithashtu me shumë kujdes një arkiv të fotografive dhe të paraqitjeve televizive të bitëlsave. Vetëm në mesin e viteve '90 të shekullit XX, kur McCartney, Starr dhe Harrison - Lennon u vra me armë zjarri në vitin 1980, Harrison vdiq në vitin 2001 - kompania filloi të mendonte se çfarë mund të vinte më pas.

Nga viti 1995, projekti i vazhdueshëm Anthology solli një seri dokumentarësh televizivë, një libër dhe tre albume të dyfishta, si edhe dy këngë "të reja" të ndërtuara mbi demo të vjetra të Lennonit. Për fat, kjo veprimtari përkoi me shfaqjen e dy vëllezërve nga Mançesteri të çmendur pas grupit Beatles. Borxhi muzikor i Noel dhe Liam Gallagher ndaj Katërshes Fantastike i ndihmoi jashtëzakonisht bitëlsat. Që atëherë, dhjetëra dokumentarë, albume të rimiksuara dhe libra ua kanë sjellë bitëlsat brezave të rinj.

I pyes dy autorë të njohur të historisë moderne shoqërore dhe kulturore britanike për mendimin e tyre mbi peshën kulturore që kanë sot Beatles. Ajo që është interesante është shkalla në të cilën mendimet e David Kynastonit dhe Alwyn W. Turnerit përputhen.

"Në përgjithësi, më duket se në këtë botë gjithnjë e më pa peshë dhe kalimtare ekziston një dëshirë e qartë nga ana e të rinjve - ose relativisht të rinjve - për diçka të qëndrueshme, siç mishërohet nga ringjallja krejtësisht e papritur e vinilit [disqeve të gramafonit]. Dhe, ndoshta Beatles përfaqësojnë një pikë të qëndrueshme e të përhershme referimi kulturor," më thotë Kynaston, duke shtuar se tërheqja e grupit qëndron te muzika që ndërthur energjinë dhe pozitivitetin me romantikën dhe mallëngjimin, ndërkohë që njëkohësisht të bën të buzëqeshësh.

Pikëpamja e Turnerit është e ngjashme. "Mendoj se po bëhemi gjithnjë e më nostalgjikë për një kohë kur kishim vërtet diçka të përbashkët - përveç lajmeve dhe futbollit, që janë gjithçka që kemi tani. Beatles janë simbol i një kohe kur vërtet kishim gjëra të përbashkëta. Natyrisht, merret si e mirëqenë se ata ishin kompozitorë jashtëzakonisht të mirë."

Ndoshta tani, më shumë se kurrë, çështjet që lidhen me trashëgiminë e grupit janë parësore. Në fund të fundit, McCartney është 84 vjeç dhe Starr është 86 vjeç. "E gjithë kjo ka të bëjë me sigurimin e trashëgimisë së tyre afatgjatë, sepse ata e dinë se koha po mbaron. Mendoj se e gjithë kjo është pjesë e kësaj," thotë Bedford.

Turneri thotë se përmasat e suksesit të bitëlsave janë "pa asnjë krahasim në terma të muzikës pop dhe kulturës pop."

Megjithatë, ai vë në pikëpyetje se sa gjatë mund të zgjasë ky adhurim. Grupi mund ta ketë tejkaluar Shekspirin, për momentin, por Turneri mendon se Bardi do ta ketë fjalën e fundit. "Dallimi me Shekspirin është se, vërtet, ato vepra do të zgjasin edhe disa qindra vjet të tjerë," thotë Turneri. "Nuk jam aspak i bindur se ndonjë muzikë pop do të zgjasë edhe 200 vjet të tjera."

/Telegrafi/

DHJETË LIBRAT MË KONTROVERSË TË TË GJITHA KOHËRAVE!

Nga: Jeremy URQUHART / Collider

Ka një histori të tërë të librave kontroversë, së cilës renditja e mëposhtme mundet t'ia prek vetëm sipërfaqen. Ekzistojnë mënyra të ndryshme se si një libër mund të shkaktojë kontroversë dhe, ndonjëherë, kontroversa është gjë e mirë - ose të paktën është e qëllimshme. Kontroversa mund të jetë edhe qesharake - nga ato gjëra që shumica e njerëzve bëjnë më mirë t'i shpërfillin, dhe mund të lindë pavarësisht nëse një libër është i mirë apo i keq.

E, pra, kjo lidhet me arsyet e ndryshme se pse një libër mund të jetë kontrovers. Në vijim bëhet fjalë kryesisht për libra të mirë që kanë nxitur përçarje për arsye të tjera që nuk ndërlidhen me cilësinë e tyre e përgjithshme. Gjithashtu, në këtë renditje të veçantë të librave më kontroversë të të gjitha kohërave do të ketë vetëm vepra letrare, prandaj, na vjen keq nëse prisni të shihni ndonjë vepër joletrare vërtet përçarëse ose historikisht alarmante (natyrisht, ka shumë të tilla)!

10. Naked Lunch, 1959 [Dreka e zhveshur]

Pra, Dreka e zhveshur është e vështirë për t'u përshkruar, dhe kjo është e qëllimshme; mund ta hasni të cilësuar si antinovelë, prandaj, edhe nëse nuk e keni dëgjuar më parë këtë term, deri diku ndoshta e dini se çfarë ju pret. Me shumë gjasë, nuk do të arrini t'u gjeni kuptim gjërave dhe romani do t'ju duket si një shaka në llogarinë tuaj.

Edhe kështu, është ende e mundur të bezdisesh nga Dreka e zhveshur, dhe pastaj është edhe gjithë ai material me shije të keqe që duhet marrë parasysh këtu, pasi bëhet fjalë për gjëra vërtet tronditëse sipas standardeve të viteve '50 të shekullit XX. Dreqi marrtë, Dreka e zhveshur është ende disi tronditëse, edhe sot, dhe padyshim po aq makthore sa mund të bëhet një libër pa u ndier si roman i mirëfilltë horrori - dhe i përkufizueshëm në mënyrë tradicionale. Këtu merrni hutim dhe neveri, dy emocione të këqija për çmimin e njërit, prandaj, a duhet të na habitë vërtet gjithë kjo polemikë dhe ky alarm i shkaktuar?

9. Brave New World, 1932 [Më e mira e botëve]

Më e mira e botëve fiton pikë sa i përket kontroversës kur merret parasysh mosha e tij dhe lloji i gjërave që paraqiste pothuajse 100 vjet më parë e për të cilat njerëzit ndoshta nuk ishin gati - të paktën jo gjerësisht. Ai përmban shumë më tepër material për të rritur sesa shumica e librave të famshëm dhe të lexuar gjerësisht të kohës së tij dhe, edhe nëse nuk është grafik sipas standardeve të sotme, alarmi që shkaktoi megjithatë duhet marrë deri diku parasysh.

Ka gjithashtu grupe të ndryshme njerëzish të cilët, në periudha të ndryshme të historisë, kanë kundërshtuar atë që Më e mira e botëve mund të jetë duke thënë ose jo për shkencën, fenë dhe shoqërinë në përgjithësi. Këtu ka lexime të ndryshme dhe gjëra të ndryshme për t'u interpretuar, prandaj Më e mira e botëve ka përfunduar duke qenë një prej atyre librave që ka shtyrë shumë njerëz të ngrenë vetullat për një varg të tërë arsyesh.

8. The Amber Spyglass, 2000 [Dylbia e qelibarit]

Ndryshe nga Më e mira e botëve, te Dylbia e qelibarit ka një pikë të vetme të vërtetë kundërshtie. Sinqerisht, përveç kësaj, libri është mjaft i sigurt për shumicën e lexuesve të rinj, megjithëse është pjesë e një trilogjie që mund të shijohet edhe nëse jeni pak më të rritur, meqë ndodhin disa gjëra të fuqishme dhe ka pasoja të qarta, ndonëse pesha e tyre nuk është aq me ndikim për një publik të të rinjve.

E gjithë trilogjia, deri diku, është kontroverse për shkak të asaj që thotë për shkencën përballë fesë, por libri i tretë, Dylbia e qelibarit, veçohet këtu sepse pikërisht në të ky konflikt del vërtet në plan të parë dhe ajo që më herët mund të ketë qenë më afër nëntekstit, këtu bëhet tekst i drejtpërdrejtë. Mund të jetë vetëm një pakicë e zëshme ajo që zemërohet me këtë libër dhe me trilogjinë, por kjo është diçka që lidhet gjithmonë me His Dark Materials [Lëndët e tij të errëta]; ndoshta edhe një elefant në dhomë të cilin, në shumicën e rasteve, ndihesh pak a shumë i detyruar ta përmendësh.

7. A Clockwork Orange, 1962 [Portokalli me kurdisje]

Portokalli me kurdisje është deri diku roman fantastiko-shkencor, por jo tamam fantastikë shkencore, pasi shkenca nuk theksohet vërtet këtu dhe romani merret më shumë me çështje shoqërore dhe me ndikimin e një lloji të caktuar teknologjie mbi shoqërinë, krimin dhe drejtësinë. Një i ri burgoset pas një serie krimesh dhe më pas, në thelb, i shpëlahet truri në mënyrë që të ndiejë neveri sa herë që i lind dëshira të bëjë diçka të dhunshme, madje edhe kur i afrohet mendimit të një veprimi të dhunshëm.

Për të funksionuar e gjithë kjo rrjedhë e ngjarjeve, është e nevojshme që personazhi kryesor të bëjë disa gjëra vërtet të tmerrshme dhe kjo është padyshim një burim kontroverse këtu. Gjithashtu, Portokalli me kurdisje është i zymtë dhe nuk ka shumë gjëra optimiste për të thënë as për shtetin, as për sistemin e burgjeve. Dhuna ushtrohet nga të dyja anët e konfliktit dhe kjo bën



që i gjithë libri të ndihet (qëllimisht) jashtëzakonisht dëshpërues dhe i pashpresë.

6. Scary Stories to Tell in the Dark, 1981 [Tregime të frikshme për t'u treguar në errësirë]

Nëse shikoni të gjithë librat horror që janë shkruar ndonjëherë, teknikisht ka libra më të frikshëm se Tregime të frikshme për t'u treguar në errësirë, sidomos nëse analizoni vetëm atë që thonë tregimet - domethënë, tekstin. Është një përmbledhje tregimesh horror drejtuar lexuesve më të rinj dhe disa prej tyre mund të jenë të fuqishme dhe tepër të frikshme për lexuesit, veçanërisht të vegjël, por janë ilustrimet në versionin origjinal të librit ato që e bëjnë atë kontrovers si tërësi.

Stephen Gammell ishte ilustruesi dhe imazhet që krijoi këtu janë vërtet disi të pakëndshme për t'u parë - edhe nëse jeni më të rritur. Ilustrimet e bëjnë kontroverse veprën Tregime të frikshme për t'u treguar në errësirë, sidomos duke qenë se, të paktën në pamje të parë, është diçka drejtuar fëmijëve. Nëse njerëzit i kanë parë disa prej këtyre vizatimeve në moshë të re dhe janë traumatizuar vërtet prej tyre, sinqerisht nuk mund t'i fajësoni.

5. American Psycho, 1991 [Psikopati amerikan]

Ja ku është Psikopati amerikan, i cili nuk ka ilustrime (edhe pse ilustrimi i kopertinës më sipër është paksa shqetësues), por, natyrisht, është shumë më ekstrem në tekstin e tij sesa Tregime të frikshme për t'u treguar në errësirë. Mund të mendoni se etiketimi si libër vetëm për lexues mbi moshën 18-vjeçare do ta pengonte të dukej tepër kontrovers dhe/ose polemizues, por Psikopati amerikan vërtet i çon gjërat shumë larg sa i përket përmbajtjes.

Nëse e keni parë filmin, atëherë libri e bën atë film të duket, në krahasim, si diçka nga Disney. Narratori këtu është tmerrësisht i keq dhe gjithashtu shumë i trazuar, ndërsa Psikopati amerikan e paraqet atë duke rrëfyer krimet e veta me hollësi grafike, teksa njëkohësisht vë po aq pasion në përshkrimin e të gjitha gjërave sipërfaqësore që përbëjnë jetën e tij. Është satirë efektive, pa dyshim, por definitivisht jo një lexim i lehtë - dhe është gjë e kuptueshme se pse libri ndonjëherë shitet me mbështjellje.

4. Gravity's Rainbow, 1973 [Ylberi i gravitetit]

Gjatë gjithë Ylberit të gravitetit ka një këmbëngulje ndaj përmbajtjes së neveritshme dhe shqetësuese që ndoshta duhet ta lexoni për ta besuar, por është gjithashtu një libër që vështirë do t'ua rekomandosh shumicës së njerëzve, pos nëse e dinë se po hyjnë në diçka vërtet ekstreme - sa u përket çështjeve postmoderne. Ngjarjet zhvillohen gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe libri përmban shumë sharje, dhunë, shthurje, gjëra neveritëse dhe përmbajtje të tjera, hëm, "eksplicite".

E gjithë kjo është në shërbim të një libri që është i vështirë të zbërthehet në kuptimin e gjetjes dhe paraqitjes së sinopsisit apo diçkaje të tillë. Disa njerëz po kërkojnë një lloj rakete dhe pastaj disa të tjerë jo, dhe ka kaq shumë njerëz, ndërsa shumë pak linja duket se ndërthuren në ndonjë mënyrë të menjëhershme të dukshme. Ylberi i gravitetit është pa dyshim tronditës dhe është i famshëm (apo famëkeq?) për faktin se e përçau Bordin Këshillues të Pulicerit [Pulitzer] në vitin 1974.

3. IT, 1986 [Ajo]

Nëse doni të zgjidhni ndonjë libër të Stephen Kingut për ta veçuar për kontroversën e tij, keni boll zgjedhje. Keni librin e shtatë të The Dark Tower [Kulla e errët], i cili ka një përfundim shumë të guximshëm dhe disi tronditës për një sagë kaq të gjatë - The Stand [Qëndresa], që përfundon në mënyrë të beftë, Pet Sematary [Varrezat e kafshëve shtëpiake] dhe atmosferën e tij veçanërisht të rëndë, dhe pastaj ndoshta edhe disa libra që kanë përçarë lexuesit për shkak të cilësisë së tyre ose mungesës së saj (o, hej, Lisey's Story/Historia e Lizit ... po, nuk mund të fshihesh; mos mendo kurrë se mund të fshihesh).

Por, Ajo i ka nga pak të gjitha. Është shumë i errët dhe ballafaques në përmbajtjen e tij, ka një fund disi alarmues dhe gjithashtu disa kapituj të fundit mjaft të çuditshëm të cilët e mbyllin një histori me të cilën duhet të kaloni shumë kohë për ta përfunduar. Është edhe fakti se në një pjesë të madhe të librit ka fëmijë, ndërsa personazheve të rinj u ndodhin gjithfarë gjërash të tmerrshme - duke nisur që në fillim me vrasjen mizore të një fëmije dhe duke u bërë vetëm më keq prej aty. Ajo është e tepërt për t'u përballuar, dhe kjo është e qëllimshme, sigurisht, por nuk është e vështirë të dallohen disa arsye pse ka shkaktuar kontroversë gjatë 40 vjetëve që gjendet në raftet e librarive.

2. Lolita (1955)

Lolita është ai libri për atë burrin, e dini, që bën ... uh ... mirë, kjo vetë dëshmon diçka për Lolitën dhe se sa konfrontues është libri. Është e vështirë të përmblidhet, sepse trajton diçka që shumica e librave nuk e prekin - edhe kur bëhet fjalë për ndonjë lloj keqbërësi që nuk haset veçanërisht shpesh dhe që bën atë që bën personazhi kryesor i Lolitës - ose diçka të krahasueshme. Te Lolita, ju jeni gjatë gjithë kohës brenda kokës së atij burri.

Dhe, ky burrë di të shkruajë, pasi korniza është se ai po shkruan më shumë një lloj kujtimesh sesa një rrëfim pendese në kuptimin më të ngushtë, meqë nuk pendohet për atë që ka bërë dhe kalon një pjesë të madhe të librit duke folur për mënyrën se si e sheh veten si superior. Është një studim ikonik i karakterit të një prej personazheve më të këqij që mund të përfytyrohen dhe, ndonëse gjërat përshkruhen me po aq hollësi grafike sa te Psikopati amerikan, Lolita fare mirë mund të duket edhe më tabu; për më tepër, u botua shumë më herët duke hedhur themelet mbi të cilat romane të mëvonshme si Psikopati amerikan dhe Portokalli me kurdisje mund të ndërtonin më tej.

1. The Catcher in the Rye, 1951 [Fëmijë në humnerë]

Fëmijë në humnerë ka mbijetuar ndër vite për disa arsye, njëra prej të cilave është se është shkruar mirë dhe është padyshim një libër interesant. Një tjetër është mënyra se si flet për tjetërsimin e të rinjve në një mënyrë mjaft të pakohë, duke e bërë të afërt për një adoleshent që e lexon në shekullin XXI, po aq sa me siguri do t'u ishte dukur i afërt lexuesve të rinj apo adoleshentë rreth mesit të shekullit XX.

Dhe, arsyeja tjetër kryesore është kontroversa. Çuditërisht, libri është lidhur me disa vrasje ose tentativa për vrasje, dhe kjo është hija që vërtet rëndon mbi një libër i cili, edhe pa këtë, është plot ankth dhe mjaft i errët. Po ashtu, mënyra pa kompromis me të cilën trajton atë që zgjedh të eksplorojë, ndërkohë që nuk druhet të ketë një protagonist/narrator shumë intensiv dhe përçarës ... pra, po. Fëmijë në humnerë, për arsye të qëllimshme dhe të paqëllimshme, është ndoshta libri më i njohur kontrovers i shkruar në gjuhën angleze. /Telegrafi/



Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Ndeshja Bjellorusi - Shqipëri do të zhvillohet pa tifozë

TIRANË, 5 NËNTOR - Ndeshja e Ligës së Kombeve mes Bjellorusisë dhe Shqipërisë do të luhet pa praninë e spektatorëve pavarësisht kërkesës së Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF) që takimi të zhvillohej me tifozë. Sipas një vendimi të Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s, të marrë më 3 mars 2022 dhe që vazhdon të jetë në fuqi, ekipet kombëtare dhe klubet bjelloruse duhet t'i zhvillojnë ndeshjet si vendase në terrene neutrale dhe pa praninë e publikut. Takimi është programuar të zhvillohet më 15 nëntor në stadiumin "Illovszky Rudolf" në Budapest të Hungarisë. Edhe pse FShF-ja kishte paraqitur kërkesë për zhvillimin e ndeshjes me spektatorë, vendimi i UEFA-s ka mbetur i pandryshuar. Për rrjedhojë, as tifozët shqiptarë nuk do të kenë mundësi të hyjnë në stadium, pavarësisht se ndeshja do të zhvillohet në Budapest dhe jo në territorin e Bjellorusisë. Shqipëria do ta mbyllë kështu aventurën në Grupin C1 me një udhëtim të pazakontë, duke kërkuar rezultatin e dëshiruar pa mbështetjen e tifozëve nga shkallët e stadiumit.

MË 20 DHJETOR FFK-ja ORGANIZON MANIFESTIMIN TRADICIONAL "LAUREATËT E VITIT 2026"

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Nën drejtimin e presidentit Agim Ademi, Komiteti Ekzekutiv i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) ka mbajtur mbledhjen e radhës, në të cilën janë shqyrtuar çështje që lidhen me organizimin, mbarëvajtjen dhe zhvillimin e futbollit në vend. Në këtë mbledhje, KE-ja ka vendosur që manifestimi tradicional "Laureatët e Vitit 2026" të mbahet më 20 dhjetor, në orën 17:00, në hotelin "Emerald". Në këtë ceremoni do të nderohen më të dalluarit e vitit në futbollin e Kosovës.

Për organizimin dhe mbarëvajtjen e manifestimit është formuar një komision treanëtarësh, në përbërje të të cilit janë Samir Ujkani, Enver Muzliukaj dhe Armend Misini. Gjatë mbledhjes është diskutuar edhe për ecurinë e garave në të gjitha kategoritë. Sipas vlerësimit të KE-së, kampionatet po zhvillohen përgjithësisht në nivel të kënaqshëm, por mbetet e nevojshme ngritja e mëtejshme e cilësisë dhe konkurrencës. Vëmendje e veçantë i është kushtuar gjendjes financiare të klubeve, me theks te domosdoshmëria e vendosjes së kritereve më të rrepta në të ardhmen, me qëllim të garantimit të qëndrueshmërisë financiare dhe përmbushjes së obligimeve ndaj futbollistëve.

KE-ja ka vlerësuar ndikimin pozitiv të projektit të FFK-së "Ndriçojmë futbollin", përmes të cilit janë vendosur reflektorë në stadiume dhe është rritur mundësia për zhvillimin e ndeshjeve në orare më të përshtatshme për shikuesit. Ndërkaq, paraqitja e klubeve të Kosovës në garat evropiane këtë edicion është vlerësuar e pakënaqshme, edhe në krahasim me sukseset e arritura në edicionet paraprake.

Sa i përket ndarjes së drejtësisë, është theksuar nevoja për vigjilencë dhe përkushtim më të madh nga zyrtarët e ndeshjeve, në mënyrë që të shmangen lëshimet. Njëkohësisht, është



kërkuar që kritikat ndaj referimit të mos jenë të ekzagjeruara. Në këtë kontekst, është vlerësuar rëndësia e themelimit të Akademisë së Gjyqtarëve dhe e trajnimit të vazhdueshëm të gjeneratave të reja, të cilat pritet të kontribuojnë në ngritjen e cilësisë së referimit në futbollin e Kosovës.

Një tjetër vendim i marrë në këtë mbledhje është që, nga stinori pranveror, edhe ndeshjet e Ligës së Parë të transmetohen përmes platformës "FIFA+", krahas ndeshjeve të Superligës së femrave, të cilat tashmë transmetohen në këtë platformë.

KE-ja ka shqyrtuar edhe ecurinë e ekipeve kombëtare. Për Kombëtaren A është konstatuar se ende qëndron brenda objektivave, ndërsa për grupmoshat e reja është vlerësuar se nevojiten rezultate më të mira. Përgjegjësi për kategoritë e reja të ekipeve kombëtare në KE, Samir Ujkani, ka paraqitur raportin për angazhimet dhe rezultatet e deritashme, duke theksuar objektivat në garat kualifikuese të UEFA-s dhe rëndësinë e zhvillimit të talenteve të reja. Në fokus të mbledhjes kanë qenë edhe projektet infrastrukturore të FFK-së. Është bërë me dije se do të vazhdojë projekti i ndërtimit të fushave të reja, ndërsa së shpejti pritet të përfundojë instalimi i reflektorëve edhe në tri stadiume të tjera. Punimet e fazës së dytë po vazhdojnë edhe në Kampin Nacional në Hajvali dhe në Shtëpinë e Futbollit, ku tashmë janë krijuar kushtet për funksionalizimin e FFK-TV-së. Duke vlerësuar se FFK-ja ka arritur të përmbushë në kohë rekord pothuajse të gjitha objektivat e strategjisë katërvjeçare, është bërë me dije se së shpejti, në bashkëpunim me UEFA-n dhe FIFA-n, do të hartohet strategjia e re, me fokus investimet në fushat ku ka zhvillim dhe përparim. Në fund, KE-ja ka shqyrtuar edhe kërkesa e parashtresa të ndryshme, si dhe çështje të tjera që lidhen me organizimin dhe zhvillimin e futbollit në Kosovë.

KUKA NGRE SHQETËSIME PËR GJENDJEN DHE ZHVILLIMIN E SPORTIT NË KOSOVË




PRISHTINË, 5 NËNTOR - Trajneri i njohur i xhudos, Driton Kuka, ka ngritur shqetësime për gjendjen dhe zhvillimin e sportit në Kosovë, duke vlerësuar se vendi nuk ka shënuar përparimin e pritur që nga pjesëmarrja e parë në Lojërat Olimpike. Në "Facebook", Kuka ka shprehur skepticizëm për numrin e sportistëve që do ta përfaqësojnë Kosovën në Lojërat Olimpike "Los Angeles 2028", duke vlerësuar se shumica e tyre mund të vijnë nga sporti i xhudos. Sipas tij, Kosova mund të kualifikojë vetëm tre ose katër xhudistë dhe një boksier, ndërsa numri i sportistëve të zhvilluar në vend mund të jetë edhe më i vogël sesa në Paris 2024.

Kuka ka bërë dallimin mes suksesit të sportistëve të zhvilluar në Kosovë dhe atyre të natyralizuar, duke theksuar se këta të fundit nuk i konsideron rezultat të punës së federatave sportive, Komitetit Olimpik të Kosovës apo Ministrisë përgjegjëse për sportin. Ai ka kritikuar gjithashtu orientimin e institucioneve sportive, duke vlerësuar se prioritet duhet të jenë rezultatet në gara dhe zhvillimi i sportistëve, e jo organizimi i garave. Në fund, trajneri i njohur ka kërkuar krijimin sa më të shpejtë të një ekipi njerëzish me integritet, i cili do të hartonte një strategji për zhvillimin e sportit në Kosovë.

Cristiano Ronaldo pensionohet nga Kombëtarja e Portugalisë

LISBONË, 5 NËNTOR - Cristiano Ronaldo ka njoftuar të enjten pensionimin nga Kombëtarja e Portugalisë. Ronaldo ka marrë këtë vendim pas zhvillimeve në ndeshjet e fundit të Portugalisë, ku nuk është përfshirë në përballjen e Ligës së Kombeve kundër Norvegjisë. Në njoftimin e tij në rrjetet sociale, Ronaldo ka thënë se ka ardhur koha për t'ia dorëzuar dikujt tjetër fanellën me numrin 7, duke pranuar se vendimi për t'u pensionuar nga kombëtarja nuk ka qenë aspak i lehtë. Që nga debutimi i tij në vitin 2003, Ronaldo është shndërruar në një nga figurat kryesore të historisë së futbollit portugez, duke e ndihmuar Portugalinë të bëhet njëra prej kombëtareve më konkurruese në Evropë. Nën udhëheqjen e tij si kapiten, Portugalia fitoi Kampionatin Evropian në vitin 2016 dhe triumfoi dy herë në Ligën e Kombeve. Gjithashtu, kombëtarja portugeze ka marrë pjesë rregullisht në Kampionatet Botërore. Në 234 paraqitje me fanellën e Portugalisë, Ronaldo ka shënuar 146 gola, duke u bërë golashënuesi më i mirë në historinë e kombëtares portugeze dhe në nivelin e futbollit ndërkombëtar për kombëtare.







NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se Edona Helshani B.I. Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810103309 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa Edona Helshani B.I. Dakovica donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810103309 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability Edona Helshani B.I. Gjakovë has come to the decision to quit its business: 810103309 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Zvogëlim i kapitalit nga firma EUROFAMIS Sh.A

Firma "EUROFAMIS" Sh.A, me numër UNIK IDENTIFIKUES, NUI: 811306431, me seli në Shirokë, Suharekë, bën zvogëlimin e kapitalit nga vlera 910.000,00 euro në vlerën 10.000,00 euro.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Milazim Dana shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën QK "11 Marsi " Prizren.

- Shaban Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Abdyl Frasheri " Prizren.

- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K "11 Marsi " Prizren.

- Trim Rezniqi shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p "Gjon N. Kazazi" Gjakovë.

- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.

- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.


100%
Fresh &
Natural
VIDAS
Llatte
drink
2%
TAMËL
PRODHUAR ME
FINESË DHE DASHURI
2,8%
Schmand
ajkë e freskët
sour cream
18% yndyrë
800g
JOGURT
DHALLË


ROYAL CROWN
RC
cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
TRADITË QË NGA
1992
MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË
PULE
GLUTEN FREE
100% MISH PULE
CILËSI E GARANTUAR
PA KONSERVUES